

MËSO NGA E KALUARA, KRIJO TË ARDHMEN

ARTET DHE E DREJTA E AUTORIT



ARTET DHE E DREJTA E AUTORIT



© Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, 2007
Teksti: Maria de Icaza
Dizajni grafik nga: Sheyda Navab

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA

ARTET

- Cilat janë artet dhe pse janë ata të rëndësishëm?
- Kush i krijon veprat e artit?
- Lojë: Autori i ri formues
- Si krijojnë autorët?
- Si e nxjerrin jetesën autorët nga veprat e tyre?

E DREJTA E AUTORIT

- Çfarë është e drejta e autorit?
- Çfarë mbron e drejta e autorit?
- Cilat janë kushtet për të drejtën e autorit?
- Si fitohet e drejta e autorit?
- Kush e ka të drejtën e autorit?
- A është e drejta e autorit njësoj në të gjithë botën?
- Çfarë të drejtash jep e drejta e autorit?
- Sa zgjat e drejta e autorit?
- A mund të transferohet e drejta e autorit?
- Lojë: Inspektori i të drejtës së autorit
- Cilat janë të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit?
- Aktiviteti i krijimtarisë
- Si menaxhohen e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të?
- Lojë: saktëso të drejtat

SEKTORI PUBLIK DHE KUFIZIMET E TË DREJTËS SË AUTORIT

- Ç'do të thotë sektor publik?
- Si mund të përdoren veprat e artit në sektorin publik?
- Lojë: Gjuetia e thesarit të sektorit publik
- Ku mund të gjenden veprat e artit të sektorit publik?
- Cilat janë kufizimet e të drejtës së autorit?

SHKELJA E TË DREJTËS SË AUTORIT

- Çfarë do të thotë shkelja e të drejtës së autorit?
- Çfarë është plagjiazmi?
- Çfarë është pirateria?
- Ç'do të thotë përdorimi i dokumentit P2P?
- Lojë: Mbrojtja e Autorëve dhe e Artistëve
- Ç'do të thotë Menaxhimi i të Drejtave Dixhitale?
- Si mund të mbrohen veprat e artit në internet?
- Lojë: Gjej shkeljen e autorit.

KONKLuzionet Përfundimtare

Përgjigjet e lojërave

Kërkesat për leje

- Dokumenti model i kërkesës për leje

Fjalorth

Lexime të tjera

Bibliografi e përzgjedhur

Burime në internet

Shënime për mësuesit

"E drejta e Autorit dhe Artet" është botimi i dytë i serisë *Mëso nga e kaluara*, krijo të ardhmen e WIPO për studentët e rinj. Kjo seri është nxjerrë duke ditur rëndësinë e fëmijëve dhe të rinjve si krijues të së ardhmes sonë.

Botimi fillon me një shpjegim të shkurtër rreth rëndësisë së arteve dhe të rinjve potencialë për tu bërë autorë të shquar. Kjo pjesë synon të inkurajojë të rinjtë të përdorin imagjinatën e tyre, fleksibilitetin dhe shprehitë e tyre për të krijuar vepra arti. Përveç kësaj, segmentet e autorëve të rinj të dhëna gjatë botimit inkurajojnë lexuesit duke i treguar atyre sesi autorë të tjerë të rinj po krijojnë vepra arti dhe si i përdorin ata të drejtat e autorit për t'i mbrojtur ata.

Pjesa kryesore e botimit jep informacion bazë rreth të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura. Kjo ndiqet nga një paragraf që i kushtohet studentëve se si mund t'i gjejnë dhe përdorin ata veprat në sektorin publik.

Pjesa e fundit e botimit shpjegon tre tipe të zakonshme të shkeljes së të drejtës së autorit dhe si mund të shmangen ato. Kjo pjesë merret veçanërisht me sfidat që paraqet teknologjia dixhitale ndaj mbrojtjes së veprave që gjenerojnë të drejtat e autorit.

Informacioni shtesë në fund të këtij botimi përfshin një fjalorth të të drejtave të autorit dhe nje letër model që mund të përdoret për të kërkuar informacion për të përdorur veprat me të drejta autori.

ARTET

Çfarë janë artet dhe pse janë ata të rëndësishëm?

Të gjitha artet janë shprehje krijuese. Njerëzit mund ta shprehin krijimtarinë e tyre:



Në mënyrë vizuale



Nëpërmjet shkrimit



Nëpërmjet lëvizjes



Në tre dimensione



Nëpërmjet zërit



Nëpërmjet multimedia-s

Shprehjet krijuese në arte quhen vepra. Shembuj të veprave janë: pikturat, fotot, këngët, romanet, poezitë, dramet, koreografia, skulpturat, ndërtesat, filmat, dhe lojrat e kompjuterit.

Autore e re: Alexandra Nechita

Aleksandra, lindur në Rumani, filloi të vizatonte dhe të pikturonte kur ishte vetëm dy vjeç. Që nga ajo kohë ajo ka kaluar orë pa fund duke pikturuar forma abstrakte me ngjyra të shkëlqyeshme duke krijuar piktura mahnitëse të cilat kanë fituar çmime nëpër botë. Veprat e saj janë vlerësuar me mijëra dollarë dhe mund të gjenden edhe në muze. Aleksandra nuk pret që njerëzit të kuptojnë çfarë thonë pikturat e saj. Në vend të kësaj, ajo që është e rëndësishme për të është se ata që shohin veprën e saj kanë mundësi të ndjejnë emocionet e shprehura nëpërmjet pikturave. Pikturat e bëjnë Aleksandrën të lumtur dhe kjo ndjesi del nga vepra e saj. Ajo ka shprehur ndjenjat e saj pozitive në piktura, skulptura madje edhe në monedha përkujtimore që promovojnë paqen.

"Është emocioni, gjendja shpirtërore me të cilën një objekt apo një ngjarje që ke ndërmend ta pikturosh mbërrin tek ti. Nuk është vetë objekti. Nëse jam duke pikturuar një llampë, po pikturoj atë ç'ka do të thotë ajo për mua. (Aleksandra në një intervistë me Orange County Register në Qershor 2003).



Artet na ndihmojnë të kuptojmë dhe të komunikojmë me kultura të ndryshme. Duke ndarë ide dhe emocione, artet na hapin mendjet dhe na bëjnë të mendojmë. Ato na lejojnë ta shohim botën ndryshe, nëpërmjet mendjes së krijuesit. Megjithatë mund të mos e kuptojmë gjuhën e një artisti, gjithsesi ne mund të kuptojmë ndjenjat dhe idetë e tij kur dëgjojmë muzikën e tij apo shohim pikturat e saj. Arti shkon përtej fjalëve duke na ndihmuar të lidhemi me njerëzit me kultura të ndryshme, pavarësisht pengesave të gjuhës apo të tjerave.

Autor i ri: Kishan Shrikanth

Kur ishte gjashtë vjeç, Kishan shqetësohej për fëmijët e pafat që shpesh i shihte duke shitur gazeta nëpër rrugët e qytetit të Indisë së tij të dashur. Ai donte t'i ndihmonte këta fëmijë dhe vendosi ta bënte këtë duke shkruar një tregim nëpërmjet të cilit shumë të tjerë do të njiheshin me këta fëmijë jetimë që nuk kishin pasur mundësi të ndiqnin shkollën. Me ndihmën dhe kurajon e familjes dhe miqve, ai filloi të xhironte një film bazuar në këtë tregim kur ai ishte vetëm dhjetë vjeç (ky film e futi atë në Librin Gines të Rekorderve Botërore). Ai e përdori këtë krijimtari dhe përvojë në rregjizurë (ai aktronte që kur kishte qenë katër vjeç) për të informuar botën rreth gjendjes së vështirë të fëmijëve të rrugës. Filmi i tij, "Të ecësh në këmbë", tregon historinë e një djali të rrugës i cili lufton për tu shkolluar. Ai shpreson që ky film të theksojë rëndësinë e arsimit dhe tu japë më shumë mundësi dhe frymëzim fëmijëve të varfër të ndjekin shkollën.

Kishan e përdori filmin për të rritur të kuptuarit e rëndësisë së arsimit për të gjithë fëmijët.



Courtesy: chitranga.com

Artet na argëtojnë

Imagjinoni një botë ku s'ka muzikë për tu dëgjuar, s'ka libra për tu lexuar, s'ka filma për tu parë apo video games për tu luajtur. Nuk ka dyshim që pa vepra artistike, jeta do të ishte shumë më pak argëtuese.

Artet shërojnë.

Qoftë me këngë, piktura apo tregime, artet ndihmojnë njerëzit të shprehin dhe t'i japin një formë emocioneve të tyre në kohë të vështira.

Autor i ri: Korneil

Në moshën 16 vjeç, talenti i Korneil si këngëtar dhe muzikant u bë i njohur në Ruandën e tij në Programin televiziv Zbulimi i talenteve. Megjithatë një vit më vonë i ndodhi një tragjedi. Korneil ishte dëshmitar i një vrasje në familjen e tij dhe për pak i shpëtoi vdekjes. Vijuan kohë të vështira pasi Korneil shkoi refugjat, duke kërkuar shtëpi në Gjermani dhe Kanada. Afro dhjetë vjet më vonë pas shfaqjes së tij të parë në Ruandë, Korneil nxori albumin e tij të parë ("Sepse ne vijmë nga shumë larg prej këtej").

Korneil i shkroi, kompozoi dhe interpretoi të gjitha këngët në këtë album si një mënyrë për të dalë nga tmerret që e kishin përndjekur qëkur humbi familjen e tij. Shpirti i tij dhe ritmet R & B me lirikat franceze flasin për përvojat e tij të shkuara por gjithashtu gëzojnë për jetën e tij të re. Muzika e Korneil jo vetëm që e ndihmoi të shëronte plagët e tij, por gjithashtu preku zemrat e qindra mijërave fansa që e bënë atë një prej autorëve interpretues më të mëdhenj francezë të kohëve të fundit. Korneil sot ndihmon Kryqin e Kuq Kanadez dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), duke marrë pjesë në koncerte dhe duke shkruar këngë që ndihmojnë për të shëruar plagët e fëmijëve që vuajnë në shumë pjesë të botës.

(Unë shpesh këndoj që të mos ulëras) - Lirikat nga kënga e Korneil "Në botë i vetmuar".



Courtesy: korneille.ca


Artet na ndihmojnë të kuptojmë historinë.

Nëpërmjet arteve ne mund ta kuptojmë botën tonë më mirë dhe të mësojmë rreth historisë dhe kulturës. Qytetërimet e shkuara shpesh kujtohen dhe kuptohen falë arteve të tyre- arkitekturës së tyre, letërsisë, pikturave, skulpturave, muzikës dhe kërcimit. Arti si për shembull pikturat e shpellave, mitet e lashta dhe këngët popullore tradicionale na ndihmojnë të kuptojmë sesi jetonin njerëzit para nesh.

Artet janë një aktivitet ekonomik i rëndësishëm

Artet janë pjesë e industrisë së kulturës, e cila krijon vende pune dhe kontribuon në pasurinë e vendeve ku janë prodhuar veprat origjinale. Seria e Harry Potter, e cila ka argëtuar miliona fansa në mbarë botën, është një shembull i shkëlqyer sesi kontribuojnë artet në punësim dhe në pasurinë e një vendi. Imagjinoni për një çast të gjitha punësimet që janë krijuar me qëllim që historia e këtij djaloshi magjistar të vijë tek fansat në mbarë botën. Njerëzit që kanë fituar të ardhura nga suksesi i kësaj serie janë:

- ◆ Autorja, J. K. Rowling
- ◆ Botuesit, redaktorët, përkthyesit, printuesit dhe tregtuesit të cilët kanë prodhuar versione në gjuhë të ndryshme të librave.
- ◆ Prodhuesit, aktorët, regjizorët, kirguesit e muzikës, teknikët dhe të gjithë punonjësit e tjerë mbështetës përgjegjës për filmat e bërë bazuar mbi librat.
- ◆ Dizenjatorët, programuesit, prodhuesit, shitësit, distributorët, dhe punëtorët në fabrika dhe dyqane të cilët prodhojnë dhe shpërndajë një numër të madh lodrash dhe produktesh të tjera bazuar në seritë.
- ◆ Guidat turistike, dhe punonjësit në hotele e restorante që ndodhen në zonat e vizituara nga turistë të cilët duan të shohin vendet ku janë xhiruar filmat.



Seriali Harry Potter ka gjeneruar mijëra vende pune dhe të ardhura për punëtorët në botë.

Imagjino pak:

- Shiko përreth dhe identifikoj të gjitha artet rreth teje.
- Çfarë tregojnë këto arte rreth kulturës së autorëve që i krijuan ato?
- Çfarë lloj arti ju pëlqen më shumë? Pse?
- Çfarë keni mësuar nga arti?
- A mund të identifikoni një apo më shumë njerëz që gjenerojnë të ardhura nga artet?

Kush krijon vepra arti?

Çdo fëmijë është një artist. Problemi është sesi të mbetesh artist kur rritesh
- Pablo Picasso

Autorët janë njerëzit që krijojnë vepra arti. Arkitektët, piktorët, kompozitorët, fotografët dhe artistët e tjerë janë të gjithë autorë të veprave të tyre. Sa herë që ne shkruajmë, vizatojmë apo nxjerrim një fotografi ne gjithashtu krijojmë veprën tonë, unike të artit. Në këtë drejtim, ne të gjithë jemi autorë.

Secili ka një talent krijues që mund të shprehet nëpërmjet artit. Të rinjtë sidomos kanë cilësi që mund t'i bëjnë ata më krijues sesa shumë të rritur. Këto hyjnë:

Imagjinata: të rinjtë kanë një imagjinatë të gjallë. Duke qenë se ata kanë më pak pritshmëri sesi duhet të jenë gjërat, mendjet e tyre rendin në drejtime të pashkelura që çojnë në krijime të reja, origjinale.

Fleksibiliteti: të rinjtë në përgjithësi janë më spontanë dhe më pak gjykues sesa të rriturit. Për rrjedhojë ata janë më të hapur ndaj ideve të reja dhe eksperimentimit me teknika të ndryshme.

Të vetë shprehurit: të rinjtë mund të jenë më të mirë se të rriturit në shprehjen dhe transmetimin e ideve dhe emocioneve të tyre. Kjo lehtësi në të shprehurit e vërtetë nxjerr krijimtarinë në artin e tyre.

Autor i ri: Xhorxh Poçeptsov

Xhorxh e ka shprehur krijimtarinë e tij në letër që kur vizatoi skicat e tij të para si bebe 17 muajshe. Krijimtaria e tij e shfrenuar del në pikturat plot ngjyra të mbuluara me kafshë imagjinare, ëngjëj dhe personazhe që shprehin pikpamjet e Xhorxhit mbi botën. Xhorxhi mësoi vetë të pikturonte dhe i pëlqen të eksperimentojë me format e kafshëve imagjinare që ai vizaton, dhe me teknikat e ndryshme të pikturës. Bota e tij imagjinare "prej letre" frymëzohet nga natyra, muzika dhe ngjarjet. Vepra e tij, shpesh e krahasuar me atë të Pikasos, shitet për mijëra dollarë.

Pikturat e Xhorxh Poçeptsov janë shprehje e imagjinatës së tij plot ngjyra.



© George Pochepstov

Mendo pak:

- Çfarë lloj arti pëlqeni të krijoni?
- Çfarë ju frymëzon kur krijoni?
- Çfarë doni të shprehni në krijimet tuaja artistike?
- A janë krijimet tuaja artistike një hapi apo do të donit të nxirrni jetesën me to?

Lojë: Autori i ri formues


Shumë autorë të famshëm filluan të krijonin vepra në një moshë shumë të re. A mund të lidhni autorët e famshëm më poshtë me veprat e para të tyre?

Bethoven



pikturoi për herë të parë një autoportret në moshën 19 vjeç

Frida Kahlo



shiti vizatimet e para në moshën 7 vjeç

Meri Shelli



botoi veprat e para muzikore në moshën 12 vjeç

Moxarti



filloi romanin e tij të parë në moshën 18 vjeç

Pikaso



shkruajti krijimin e parë muzikor në moshën 5 vjeç

Uollt Diznej



© Disney Enterprises, Inc.

perfundoi pikturën e parë të njohur në moshën 8 vjeç

* Shih faqen 58 për përgjigjet

Si krijojnë autorët?

Të krijosh një vepër arti kërkon shumë më tepër sesa një frymëzim dhe krijim. Shumica e autorëve studiojnë dhe ushtrohen me orë të tëra para se ata të prodhojnë një vepër të përfunduar. Megjithëse autorë të ndryshëm përdorin teknika të ndryshme, janë të paktën katër hapa në të cilat kalojnë shumica e tyre:

1. Bëhet një **skicë** e veprës. Kjo mund të jetë një imazh bruto e një pikturë, një skicë e një tregimi, apo një përzgjedhje e fjalëve kryesore të një poezie apo kënge.
2. **Zhvillohet** skica duke i dhënë asaj më shumë formë dhe përmbajtje.
3. **Ripërpunohet** skica duke i shtuar detaje dhe duke fshirë elementët e panevojshëm.
4. Prodhohet një kopje përfundimtare e veprës.

Gjatë këtij procesi, autorët shpesh e gjejnë frymëzimin në veprat e tjera të artit. Një pikurë, për shembull, mund të prodhojë një ide për një tregim, ose të dëgjosh muzikë mund të frymëzojë goditjet e furçave të një piktori. Të studiosh vepra të tjera përmirëson gjithashtu aftësitë e një autori. Kjo është një nga arsyet që shumica e autorëve pëlqejnë të dëgjojnë, të lexojnë dhe të shikojnë vepra të autorëve të tjerë.

mendohu

Përdorni hapësirën më poshtë për të krijuar një vepër origjinale duke shprehur diçka që keni kaluar dje. Kjo mund të jetë diçka që e keni bërë, thënë, dëgjuar, parë ose ngrënë. Ju mund ta shprehni me një vizatim, një tregim, një këngë ose çdo formë tjetër arti që ju preferoni. Përdorni hapat në faqen 12 si udhëzues në procesin e krijimit.

Si e nxjerrin autorët jetesën nga veprat e tyre?

Jo të gjithë autorët mund të fitojnë para nga veprat e tyre. Të bësh vepra arti cilësore që të tjerët kanë dëshirë t'i blejnë kërkon krijimtari, talent, para dhe kohë. Që të krijojnë autorët kanë nevojë për para të blejnë pajisjet e tyre dhe të paguajnë për trajnim që të përmirësojnë aftësitë e tyre. Gjithashtu, nëse ata ia kushtojnë pjesën më të madhe të kohës krijimit të veprave, zakonisht ata nuk do të kenë kohë të punojnë në një punë tjetër. Për rrjedhojë, autorët kanë nevojë të marrin pagesë për veprat e tyre në mënyrë që të paguajnë faturat e tyre.

Në të shkuarën, autorët e talentuar zakonisht e gjenin kohën dhe paratë për tu përqëndruar në artin e tyre me ndihmën e përkrahësve. Këta sponsorë ishin njerëz të pasur dhe me pushtet, të tillë si mbretërit dhe drejtuesit fetarë, të cilët iu kërkonin autorëve të krijonin vepra arti për ta. Ndërsa sponsorizimi i këtyrë njerëzve të pasur i lejonte autorët e talentuar të vazhdonin krijimtarinë, shumica e njerëzve nuk kishin të drejtë t'i shihnin veprat e tyre. Në atë kohë, veprat ishin krejt unike, me një kopje në dispozicion për kënaqësinë e përkrahësit i cili paguante për krijimin e tij.



Nëse ata pikturonin varret për faraonët apo kompozonin simfoni për perandorët, autorët kishin nevojë të gjenin një përkrahës t'i sponsorizonte krijimin e veprave të tyre.



Me kohë, teknologjia e ndryshoi thellë situatën e autorëve duke e bërë më të lehtë për të tjerët të bënin kopje të veprave të tyre. Në 1454, shpikja e shtypit të shkruar e Gutenbergut bëri të mundur të printoheshin shumë kopje të veprave të shkruara me çmime të ulëta. Kjo bëri që veprat e shkruara mund t'i kishin jo vetëm të pasurit dhe të pushtetshmit por të gjithë njerëzit që mund të lexonin. Që atëherë, teknologjitë e reja kanë vazhduar të prodhojnë vepra më të arritshme për të gjithë njerëzit. Media moderne e tillë si fotografia, radio, televizioni, disqet, DVD-të, kompjuterat dhe interneti e bëjnë më të lehtë dhe më të lirë të kopjohen dhe të shpërndahen të gjitha llojet e veprave sot sesa në çdo kohë tjetër.



Shtypi i printuar modern ishte teknologjia e parë që do të ndikonte në mënyrën sesi autorët kontrollojnë riprodhimin dhe shpërndarjen e veprave të tyre.

Sot që veprat janë më të arritshme për të gjithë në çdo cep të botës, autorët nuk mbështeten më tek sponsorët e pasur për të cilët ata krijojnë kopje unike të veprave. Për të fituar jetesën tani, autorët kanë nevojë të kenë njëfarë kontrolli mbi mënyrën sesi përdoren kopje të ndryshme të veprave të tyre. Pa këtë kontroll ata nuk do të ishin në gjendje të fitonin para të mjaftueshme për të jetuar me artin e tyre, dhe do t'iu duhej të gjenin punë tjetër për të paguar faturat e tyre. Kjo do t'i linte atyre më pak kohë për të krijuar vepra të reja dhe të gjithë ne do të kishim më pak vepra për tu kënaqur.

Për të inkurajuar dhe aktivizuar autorët e talentuar të vazhdojnë të krijojnë, shumica e vendeve sot u japin atyre të drejta të posaçme për të kontrolluar veprat e tyre. Këto të drejta njihen si e drejta e autorit.

E DREJTA E AUTORIT?

Ç'është e drejta e autorit?

Dikush pikturon me trurin e tij dhe jo me duart e tij - Mikelanxhelo

Pronësia intelektuale i referohet të gjitha krijimeve të mendjes njerëzore. Pronësia intelektuale ndahet në të **Drejtën e Autorit** dhe në të **Drejtat e lidhura** nga njëra anë dhe **Pronësia Industriale** nga ana tjetër.



Krijimet e mendjes njerëzore mbrohen nga ligjet e pronësisë intelektuale.

Pronësia intelektuale

E drejta e autorit

- Mbron veprat origjinale.

Të drejtat e lidhura:

- Mbrojnë shfaqjet, rregjistrimet origjinale dhe transmetimet e veprave.

Pronësia industriale:


- Patentat mbrojnë shpikjet.
- Skicat industriale mbrojnë skicat e produkteve.
- Markat tregtare mbrojnë shenjat dalluese.

Imagjinoni:

Nganjëherë mund të aplikohet më shumë sesa një tip pronësie intelektuale për një produkt të vetëm.

Mendoni, për shembull, një frigorifer. Një markë tregtare mund të mbrojë emrin dhe logon e prodhuesit të frigoriferit. Pjesët dhe proceset e frigoriferit që mbajnë ushqimin freskët mund të jenë shpikje të patentuara. Skica e frigoriferit (stili dhe pamja e sirtarëve, rafteve, dorezave etj.) mund të mbrohen nga skicat industriale. Edhe udhëzuesi i funksionimit të frigoriferit, një tekst origjinal me shkrim, mbrohet nga e drejta e autorit.

A mund t'i imagjinoni produktet e tjera që mund të mbrohen nga më shumë se një tip pronësie intelektuale?



Çfarë mbron e drejta e autorit?

E drejta e autorit mbron një kuadër të gjerë veprash, i cili mund të përfshijë:



Veprat me shkrim - librat, ligjëratat, artikujt e revistave dhe të gazetave, romanet, tregimet, poezitë, esetë, dramat, tekstet e librave, faqet e internetit, reklamën, dhe shënimet e kërcimeve.



Veprat muzikore - krijimet muzikore, lirikën, këngët dhe meloditë e zileve të celularit, në të gjitha tipet e formateve (fletat muzikore, disqet, fajlet e MP3, etj.).



Veprat artistike - vizatimet, pikturat, fotografitë, pjesët komike, skulpturat, veprat e arkitekturës dhe hartat.



Veprat dramatike dhe koreografike - dramat, operat dhe kërcimet.



Filmat dhe produktet multimedia - filmat, video games, programet televizive dhe filmat multiplikativë.



Programet e kompjuterit - gjuha e programimit të kompjuterit njerëzor (kodi i burimit) dhe me makinë (kodi i objektit).

E drejta e autorit **NUK** mbron idetë ose faktet e thjeshta.

E drejta e autorit mbron mënyrën me të cilën janë shprehur idetë. Kjo shprehje është mënyra e vetme me të cilën janë zgjedhur dhe sistemuar fjalët, notat muzikore, ngjyrat, format etj. Ajo është shprehja që bën një vepër origjinale. Kjo do të thotë që mund të ketë vepra të ndryshme mbi të njëjtën ide dhe të gjitha ato të mbrohen nga e drejta e autorit, për aq kohë sa ato e shprehin këtë ide në një mënyrë origjinale.

Për shembull, mësuesi juaj mund t'iu kërkojë juve dhe shokëve tuaj të klasës të vizatoni pikturën e një qeni duke luajtur me top. Edhe pse ideja (qeni duke luajtur me top) është e njëjtë, të gjithë ju do të zgjidhni ngjyra dhe forma të ndryshme për të shprehur (vizatuar) qenin dhe topin. Megjithëse vizatimet janë shprehje të të njëjtës ide, ato do të jenë origjinale dhe për rrjedhojë do të mbrohen nga e drejta e autorit.



Një ide (e tillë si një qen duke luajtur me top) mund të shprehet në shumë mënyra të ndryshme. E drejta e autorit mbron vetëm shprehjen e idesë, jo vetë idenë.

Mendojeni:

A mund të mendoni sesi mund të shprehet një ide në mënyra të ndryshme në tre vepra origjinale? Ja një mënyrë për të filluar.

Ideja:

Një aventurë qeni.

Veprat origjinale që shprehin atë ide:

Romani The Call of the Wild nga Jack London.
Filmi Bethoven nga Universal Studios.
Loja Jeta e Qenit PlayStation 2 nga Frontier Developments.

Autor i ri: Kristofer Paolini

Kristofer pëlqen aq shumë të lexojë aventura fantastike sa në moshën 15 vjeç ai vendosi të shkruante tregimin e tij. I frymëzuar nga ideja e një djali i cili sheh një dragua që kllloqitet në një vezë për të dalë (nga libri i Bruce Coville Jeremy Thatcher, Lindësi i Dragoit), autori i ri krijoi një triologji fantastike për një djalë, mikun e tij dragua dhe udhëtimin e tyre të rrezikshëm për të shpëtuar botën nga djalli. Për tregimin e tij Kristofer u frymëzua gjithashtu nga vepra të tjera fantastiko shkencore, përfshi serialin the Lord of the Rings (Pronari i unazave) nga J.R.R. Tolkien, nga seriali Lufta e Yjeve e George Lucas. Megjithëse u frymëzua qartë nga ide të përdora në vepra të tjera, mënyra sesi Kristofer i shprehu këto ide (linja e ngjarjes, përshkrimet, personazhet dhe dialogu) është origjinale, dhe për rrjedhojë mbrohen nga e drejta e autorit. Kur Kristofer ishte 19 vjeç, pati sukses libri i tij i parë Eragon, duke shitur miliona kopje në mbarë botën dhe duke zënë një vend në listën e New York Times të librave më të shitur.

Tregimi i Kristofer, i cili i mori idetë nga romane të mëparshme, ka frymëzuar sot krijimin e veprave të tjera origjinale: përkthimet e librit në më shumë sesa 30 gjuhë, bërjen e filmit, dhe video game.




Courtesy: Random House, Inc.

Cilat janë kushtet e të drejtës së autorit?

Në shumë raste, **origjinaliteti** është kushti i vetëm që një vepër duhet të plotësojë me qëllim që të mbrohet nga e drejta e autorit. Kjo do të thotë se një vepër nuk mund të jetë thjesht kopje e një vepre tjetër.

E drejta e autorit mbron veprat origjinale, pavarësisht cilësisë së tyre.



Një vepër nuk ka pse të jetë e dobishme, e bukur, apo me vlerë për tu mbrojtur nga e drejta e autorit. Në fakt, veprat mbrohen nga e drejta e autorit pavarësisht cilësisë së tyre. Një pikturë nga gishti i një fëmije ka po aq të drejta autori sa një kryevepër e një piktori të famshëm. Një melodi në një pikë tregtare është po aq e mbrojtur nga e drejta e autorit sa kënga më e fundit e një grupi tuaj të preferuar. Shkrimet origjinale në ditarin tuaj kanë gjithashtu po aq mbrojtje të të drejtës së autorit sa romanet e fituesit të Çmimit Nobel.



© Qeveria e Hong Kong, Kinë. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Falenderim i veçantë për Departamentin e Pronësisë Intelektuale të Hong Kong, Z. Lee Min-chi, dhe Grupin Jade Dynasty

Disa vende kërkojnë gjithashtu që një vepër të fiksohet në një formë të prekshme para se të mbrohet. Një vepër mund të fiskohet në disa mënyra të ndryshme, ajo mund të shkruhet në letër, të pikturohet në kanvas, të rregjistrohet (me zë dhe/ose video) etj. Për shembull, në vende që kërkojnë fiksimin e një vepre, një koreografi kërcimi mbrohet vetëm pasi lëvizjet janë hedhur në fletë me simbole, janë rregjistruar me video ose janë fiksuar në një formë tjetër.

Si fitohet e drejta e autorit?

Mbrojtja e të drejtës së autorit është automatike. Kur ju vizatoni një pikturë apo shkruani një poezi, veprat tuaja mbrohen nga e drejta e autorit.

Simboli © shpesh përdoret për të kujtuar që vepra mbrohet nga e drejta e autorit. Ky simbol shpesh ndiqet nga emri i pronarit të të drejtës së autorit dhe viti në të cilin është krijuar vepra. Për shembull, "© WIPO, 2007" do të përdoret për një botim të prodhuar nga WIPO në vitin 2007.

Në faqet e internetit simboli © mund të vazhdojë për më shumë sesa një vit, për shembull "© WIPO 1999-2007". Ky lloj citimi përdoret për veprat që përditësohen në mënyrë konstante. Viti i parë është viti i botimit të parë të veprës (viti kur është lançuar faqja e WIPO) ndërsa viti i dytë është ose viti aktual ose viti i përditësimit të fundit.

Meqënëse simboli © është vetëm një kujtues, nuk është e nevojshme që të përfshihet në vepër se duhet mbrojtur. Edhe nëse një vepër nuk e ka simbolin ©, ai përsëri mund të mbrohet nga e drejta e autorit.

Imagjinoni:

Kthehuni tek vepra që krijuat në faqen 13. Futni shënimin e të drejtës së autorit me simbolin ©, emrin tuaj dhe vitin në të cilin përfunduat veprën tuaj.

Kush e ka të drejtën e autorit?



E drejta e autorit e një vepre të veçantë zotërohet nga personi i cili e krijoi atë vepër. Siç e pamë më parë, krijuesi shpesh quhet autori i veprës. Për shembull, ju krijuat gazetën tuaj, projektin e artit tuaj dhe fotot nga pushimet tuaja të fundit. Ju jeni autori i cili ka të drejtën e autorit për të gjitha këto vepra.

Nganjëherë veprat krijohen nga më shumë sesa një person. Në këto raste, të gjithë njerëzit që kontribuan në krijimin e veprës konsiderohen bashkëautorë të saj dhe ata ndajnë të drejtën e autorit mbi **veprën kolektive**.





Në disa raste, autorët dëshirojnë të mbeten anonimë ose të përdorin një pseudonim me qëllim që të fshehin identitetin e tyre të vërtetë nga publiku. Në këto raste, autori përsëri ka të drejtë autori mbi veprat e tij, megjithëse të drejtat e tij zakonisht menaxhohen nga shoqëria shpërndarëse e veprave (për shembull, botuesi i tij) në mënyrë që ta ruajë mister identitetin e tij të vërtetë.

Mendoni:

Në 1967, gjashtëmbëdhjetëvjeçarja Susan Eloise Hinton shkruajti "Outsiders" (jashtë loje) një roman rreth dy grupeve kundërshtarë adoleshentësh rebelë. Ngjarja u shkruajt nga këndvështrimi i një djali dhe botuesi i Suzanës u shqetësua se lexuesit nuk do ta merrnin aq seriozisht librin, nese do të merrnin vesh që autori ishte vajzë. Libri fshehte pjesën e identitetit të autorit duke përdorur inicialet e saj, S.E., në vend të emrit të saj të plotë.

- A mund t'i gjeni dot arsyet pse autorët nganjëherë duan ta fshehin një pjesë të identitetit të tyre ose të gjithin duke mbetur anonim ose duke përdorur pseudonime?
- A mund të gjeni ndonjë vepër nga autorë të tjerë që kanë mbetur anonim ose kanë përdorur pseudonime?

Në disa vende, kur një person krijon një vepër të re si pjesë e kontratës së tij të punës, shoqëria ose institucioni që e punëson atë mund të ketë të drejtën e autorit mbi veprën.



Dijeni!!

Të kesh një kopje fizike apo elektronike të një vepre nuk ju bën pronar të të drejtave të autorit që ajo ka. Për shembull, ju mund të keni një libër por kjo nuk ju bën ju pronarin e të drejtave të autorit për tekstin dhe imazhet që janë në atë libër. Po ashtu, të bleni një disk nuk do të thotë se ju keni blerë gjithashtu të drejtën e autorit mbi muzikën, tekstin, dhe imazhet që janë në atë disk.

Meqë ju nuk keni të drejtë autori për përmbajtjen e librave, dhe disqeve që keni, ekzistojnë kufi të qartë për atë që ju mund dhe nuk mund të bëni me këto produkte. Lexoni për të zbuluar cilat të drejta janë të kufizuara për pronarët e të drejtës së autorit.

A është e drejta e autorit njësoj në të gjithë botën?

Të drejtat e veçanta të dhëna autorëve nëpërmjet të drejtës së autorit varen nga ligjet kombëtare. Për shkak të kësaj, të drejtat e autorit në një vend mund të mos jenë ekzaktësisht njësoj si të drejtat e autorëve në një vend tjetër. Kjo mund ta ngatërrojë përdorimin e veprës, sidomos në një botë ku veprat mund të gjeihen lehtë në vende të ndryshme (për shembull, nëpërmjet internetit). Me qëllim që të zvogëlohet kjo ngatërresë, shumë qeveri kanë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare që përpiqen të reduktojnë ndryshimet në ligjet e tyre të të drejtës së autorit dhe që lehtësojnë përdorimin e veprave në botë.

Marrëveshja e parë ndërkombëtare që u përpoq të reduktonte ndryshimet në të drejtat që i jepen autorit në vende të ndryshme ishte **Konventa e Bernës**. Viktor Hygo, autori i famshëm francez i Të Mjerët, mori pjesë në krijimin e kësaj Konvente. Ai dhe autorë të tjerë, donin të siguronin që të drejtat e tyre të respektoheshin edhe në vende të tjera ashtu si në vendin e tyre.

Autori Viktor Hygo mori pjesë në krijimin e Konventës së Bernës



Që nga miratimi i Konventës së Bernës në 1886, autorët kanë gëzuar një tërësi të drejtash të përbashkëta në më shumë sesa 160 vende të cilat kanë nënshkruar Konventën (Shtetet e saj anëtare).

Çdo shtet anëtar i Konventës së Bernës duhet të ofrojë mbrojtje të njëjtë të veprave nga autorë të Shteteve të tjera Anëtare siç i ofron vendi i tyre. Përjashtim nga kjo bën rregulli i afatit më të shkurtër. Sipas këtij rregulli, një Shtet Anëtar nuk është i detyruar të ofrojë mbrojtje veprave të një autori të huaj për më shumë kohë seç i jepet atyre veprave në vendin e originës së autorit.

Përveç kësaj, sipas Konventës së Bernës, veprat nuk kanë nevojë të rregjistrohen me qëllim që të mbrohen nga e drejta e autorit. Mbrojtja e të drejtës së autorit është automatike nga momenti që krijohet vepra.

Mendojeni?

A është vendi juaj një Shtet Anëtar (palë kontraktuese) e Konventës së Bernës?
Gjejeni në <http://www.WIPO.int/treaties/en/ip/berne>

Nëse po, veprat tuaja janë automatikisht të mbrojtura nga një tërësi të drejtash si në vendin tuaj ashtu edhe në të gjitha vendet e tjera që janë gjithashtu Shtete Anëtare të Konventës së Bernës.



Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) punon me zyrtarët qeveritarë të vendeve të ndryshme për të zhvilluar dhe përditësuar marrëveshje ndërkombëtare për të drejtën e autorit.

Nga selia në Gjenevë, Zvicër, WIPO ndihmon të mbrohen të drejtat e autorit.

Çfarë të drejtash siguron e drejta e autorit?

E drejta e autorit i pajis autorët me një tërësi të drejtash ekskluzive mbi veprat e tyre. Ekskluzive do të thotë që ka gjëra që vetëm autorët mund t'i ushtrojnë mbi veprat e tyre. Në disa raste autorët marrin një të drejtë shpërblimi në vend të një të drejte ekskluzive. Në këto raste, autori mund të marrë pagesë për përdorimin e veprës së tij, por nuk mund të ndalojë përdorimin. Si e drejta ekskluzive ashtu edhe e drejta e shpërblimit shërbejnë për të shpërblyer autorët për krijimtarinë e tyre, investimin dhe punën, dhe t'i inkurajojnë ata të vazhdojnë të prodhojnë vepra të reja.

Sipas Konventës së Bernës, ka dy tipe të drejtash për të drejtat e autorit:

(1) Të drejtat ekonomike - Autorët kanë të drejtë ekskluzive të:

- riprodhojnë veprën.** Kjo përfshin çdo formë kopjimi të tillë si fotokopjimi, shkarkimi, ngarkimi, printimi, rregjistrimi, fotografimi, skanimi, etj.
- përkthejnë veprën** në gjuhë të tjera.
- përshtasë veprën.** Ky ndryshim apo transformim zakonisht ndryshon tipin e veprës. Për shembull, të bësh film një roman, ose të animosh një vizatim në multiplikativë. Tregtimi i personazhit (duke përdorur emrin ose imazhin e një personazhi filmi për të shitur produkte të tilla si lodra, bluza, etj.) mund të quhet gjithashtu një formë përshtatje.
- Shfaqë/interpretojë veprën në publik.** Për shembull, paraqitja e fotove në një galeri arti, interpretimi i një pjese përballë një publiku, ose dëgjimi i një disku në një dyqan apo një restorant.

- e) **Shpërndajë** veprën duke ia shitur kopjet publikut.
- f) **Transmetojë** veprën. Për shembull, duke transmetuar një këngë në radio apo duke dhënë një film në televizor.
- g) **Komunikojë** veprën në publik. Për shembull, duke ngarkuar një vepër në internet.

Për ta përmbledhur, asnjë vepër me të drejta autori nuk mund të riprodhohet, përkthehet, përshtatet, shfaqet apo interpretohet në publik, shpërndahet, transmetohet apo komunikohet në publik pa lejen e autorit të tij. Ky është kuptimi i shprehjes të gjitha të drejtat e rezervuara që shkruhet në shumë vepra.

Dijeni!!

Ka një kufi mbi të drejtën e autorit për shpërndarjen, të quajtur **doktrina e shitjes së parë**. Detajet e veçanta të këtij rregulli varen nga ligjet kombëtare dhe për rrjedhojë mund të ndryshojnë nga vendi në vend. Në përgjithësi, megjithatë, ky rregull do të thotë se e drejta e shpërndarjes për çdo kopje të veprës mbaron me shitjen e kopjes së parë të saj. Kjo do të thotë që personi i cili blen një kopje të veprës ka të drejtë ta rishpërndajë atë kopje.

Për shembull, nëse ju blini një disk muzike, ju mund t'ia ofroni atë një shoku si dhuratë, ose ta rishisni atë tek një tregtar i dorës së dytë. Megjithatë, ju nuk mundeni të ngarkoni këngët e diskut në internet përderisa ajo do të kërkonte të prodhohej një kopje elektronike e këngëve. Megjithëse ju mund të rishpërndani një kopje të veçantë të veprës pasi e bleni, e drejta e riprodhimit prapë është një e drejtë ekskluzive e autorit.



(2) **Të drejtat morale** - këto janë të drejta të cilat ruajnë një lidhje personale midis autorëve dhe veprave të tyre. Ato përfshijnë të drejtën për:

- a) Tu njohur si autor i një vepre (e drejta e atësisë). Kjo do të thotë se autorët mund të zgjedhin të firmosin me emrat e tyre, të mos firmosin me emrat e tyre (të mbeten anonimë), ose të firmosin me një emër të trilluar (të përdorin një pseudonim) mbi veprat e tyre.
- b) Të kundërshtuar çdo ndryshim në vepër, e cila do të dëmtonte nderin apo reputacionin e autorit (e drejta e integritetit).

Sa zgjat e drejta e autorit?

Mbrojtja e të drejtës së autorit nuk zgjat përjetësisht. Kohëzgjatja e mbrojtjes ndryshon sipas:

- ◆ Ligjit kombëtar të çdo vendi
- ◆ Atij që krijoi veprën.
- ◆ Llojit të veprës.



Në vende që janë anëtarë të Konventës së Bernës, e drejta e autorit zgjat gjatë gjithë jetës së autorit plus 50 vjet pas vdekjes së autorit. Megjithatë, në shumë vende e drejta e autorit zgjat më shumë sesa afati minimal. Për shembull, në SHBA dhe në vende të Bashkimit Europian, mbrojtja e të drejtës së autorit zakonisht zgjat gjatë jetës së autorit plus 70 vjet pas vdekjes së autorit.

Të drejtat ekonomike iu kalojnë trashëgimtarëve të autorit pasi autori vdes. Ata bëhen mbajtësit e të drejtave për veprat e autorit të vdekur. Këta mbajtës të drejtash vazhdojnë të marrin pagesë për riprodhimin, përkthimin, përshtatjen, shfaqjen publike, shpërndarjen, transmetimin dhe komunikimin në publik të veprës për aq kohë sa zgjat mbrojtja e të drejtave të autorit pas vdekjes së autorit.



Djali që nuk do të rritet kurrë
Për shembull, para vdekjes së tij në 1937, autori skocez J. M. Barrie ia dhuroi të drejtën e autorit për romanin e tij Piter Pan Spitalit të Londrës Great Ormond Street. Ky spital, për rrjedhojë, ka të drejtën e autorit mbi Piter Pan dhe ka të drejtë të ndalojë/lejojë dhe të detyrojë të paguajnë për çdo shfaqje, përshtatje, dhe botime të tregimit Piter Pan.

Të drejtat morale zakonisht zgjasin të paktën aq sa të drejtat ekonomike, megjithëse në disa vende ato zgjatin përjetësisht. Në varësi të ligjeve kombëtare, të drejtat morale gjithashtu mund t'i kalojnë trashëgimtarëve të tyre, të cilët sigurojnë që autori i vdekur vazhdon të njihet si autor i veprave të tij dhe se nderi e reputacioni i tij nuk janë dëmtuar nga ndonjë ndryshim mbi vepra.

Në rastin e veprave të krijuara nga më shumë se një autor, fundi i mbrojtjes së të drejtës së autorit llogaritet nga koha e vdekjes së bashkëautorit të fundit mbijetues. Për shembull, autorët francezë Rene Goscinny dhe Albert Uderzo krijuan së bashku librat komikë Asterix. Rene Goscinny vdiq në 1977 por e drejta e autorit mbi këto vepra kolektive do të skadojë vetëm 70 vjet pas vdekjes së Albert Uderzo, bashkëautorit të fundit jetues.

Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave anonime dhe pseudonime llogaritet nga koha kur ato janë botuar. Megjithatë, nëse identiteti real i autorit njihet qoftë dhe me pseudonim, mbrojtja e të drejtës së autorit ka të njëjtën kohëzgjatje si për autorët e tjerë të njohur (deri të paktën 50 vjet pas vdekjes së tyre).

Kur autori i një vepre është më shumë një korporatë apo institucion sesa një individ, kohëzgjatja e mbrojtjes së autorit llogaritet gjithashtu nga koha e botimit të veprës.

Së fundi, në shumë vende, filmat dhe fotografitë kanë afate të ndryshme (zakonisht më të shkurtra) mbrojtjeje sesa veprat e tjera.

Mendojeni?

Sa zgjat mbrojtja e të drejtës së autorit në vendin tuaj? A ndryshon ajo në varësi të personit që e krijoi dhe llojit të veprës?

Ju mund ta gjeni përgjigjen e këtyre pyetjeve duke kontaktuar zyrën tuaj kombëtare të të drejtës së autorit ose duke lexuar ligjet tuaja kombëtare të të drejtës së autorit. Nje vend se ku mund të gjeni informacion rreth ligjeve të vendit tuaj për të drejtën e autorit është baza e të dhënave WIPO's

CLEA (Koleksioni i Ligjeve për Përdorim Elektronik): <http://www.WIPO.int/clea/en/index/jsp>



A mund të transferohet e drejta e autorit?

Autorët mund të vendosin të shesin të drejtat e tyre të autorit për veprat e tyre. duke shitur të drejtat e tyre të autorit, autorët mund të përqendrohen në krijimin e veprave të reja ndërkohë që njerëz të tjerë kujdesen për riprodhimin, përkthimin, përshtatjen dhe shpërndarjen e veprave të tyre të vjetra. Ata të cilët blejnë të drejtat ekonomike të autorëve quhen gjithashtu mbajtës të të drejtave.

Të drejtat morale janë të pavarura nga të drejtat ekonomike dhe mbeten gjithmonë me autorin, edhe kur të drejtat ekonomike janë shitur.

Autorët që shesin të drejtat ekonomike të veprave të tyre marrin pagesa të quajtura **honorare**. Ka dy mënyra për shitjen e të drejtave të autorit:

Transferime dhe **licensa**.

Transferimi është një mënyrë transferimi i një ose më shumë të drejtave ekonomike të autorit në mënyrë që ai person i cili blen të drejtën (at) të bëhet pronari i ri i të drejtës së autorit. Jo të gjitha vendet i lejojnë transferimet.

Licensimi do të thotë që autori të mbetet pronari i të drejtave të tij ekonomike por lejon blerësin (apo të licensuarin) e të drejtave të kryejë veprime të caktuara që mbulohen nga këto të drejta për një kohë dhe qëllim të kufizuar. Për shembull, autori i një romani mund t'i japë të drejtat e tij të riprodhimit dhe shpërndarjes një botuesi. Ai gjithashtu mund t'i japë të drejtat e tij të përshtatjes një prodhuesi filmi i cili dëshiron të bëjë një film bazuar në roman.

Përfundimisht, një autor mund të vendosë të mos përdorë disa ose të gjitha të drejtat e tij. Për shembull, ai mund të ngarkojë veprat e tij në internet dhe të specifikojë se çdo njeri mund t'i përdorë ato pa pagesë. Ai gjithashtu mund të dëshirojë të kufizojë përdorimin mbi veprën që ai ka ngarkuar, për shembull duke lejuar që vepra e tij të përdoret vetëm për qëllime jo tregtare. Në këtë rast, ai do të lejonte të tjerët ta kopjonin, ta përkthenin, ta përshtasin, ta interpretojnë dhe madje ta transmetojnë veprën për aq kohë sa ata nuk fitojnë asnjë para nga këto përdorime.

Organizata të tilla si Creative Commons japin shembuj sesi autorët mund t'i etiketojnë veprat e tyre në mënyrë që të jetë e qartë se çfarë të drejtash aplikohen mbi to. Ju mund të gjeni më shumë informacion rreth kësaj në faqen e internetit: <http://creativecommons.org/>

Autor i ri: Flavia Bujor

Në moshën dymbëdhjetë vjeçare, Flavia filloi të shkruajë një histori për tre vajza të reja që përpiqeshin ta mbronin botën e fantazisë me ndihmën e gurëve magjikë. Dy vjet më vonë, në Francë u botua libri i saj, Profecia e Gurëve. Libri papritur u bë libri më i shitur dhe më shumë sesa 20 botues tregtarë vrapuan të blinin të drejtat për ta përkthyer, botuar dhe shitur librin e Flavia-s në vendet e tyre.

Romani i saj është shitur në më shumë se dhjetë mijë kopje në Francë, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara.

Flavia shiti të drejtat e përkthimit, riprodhimit dhe shpërndarjes së librit të saj.



Në shenjë respekti: Hyperion Librat për fëmijë

Lojë: Inspektori i të drejtave të autorit

Shikoni mirë më poshtë kopertinën dhe faqen e brendshme të librit imagjinar dhe identifikoni:

Kush i ka të drejtat morale të tekstit origjinal, në gjuhën portugeze?

Kush i ka të drejtat morale të përkthimit të tekstit në gjuhën angleze?

Kush i ka të drejtat e autorit për punën artistike në kopertinë?

Kush i ka të drejtat e botimit?

Cilat janë të drejtat ekonomike që përfshihen në referimin të gjitha të drejtat e rezervuara?




ENDERR AMAZONIANE Nga A. Chico

Përkthyer nga origjinali në gjuhë portugeze nga: J. Little

Dizajni i kopertinës:
Carlos Mayorga
©2006 Botuesit XYZ
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

* Shih faqen 58 për përgjigjet



Cilat janë të drejtat e lidhura?

Veprat artistike janë shpesh në dispozicion për publikun nëpërmjet sherbimeve të intepretuesve, prodhuesve të fonogramave dhe transmetuesve. Mendoni, për shembull, një këngë të dhënë në radio. Pasi autorët (shkrimtari i këngës dhe kompozitori i muzikës) krijojnë këngën, më pas ajo interpretohet nga këngëtarët dhe muzikantët, rregjistrohet nga një prodhues fonogramash, dhe shpërndahet nga një transmetues.

Interpretimi, rregjistrimi dhe transmetimi i veprave kërkon një investim të madh kohe dhe paraje. Me qëllim që të merret ky investim dhe të inkurajohen që të jenë në dispozicion të publikut sa më shumë vepra, qeveritë i japin interpretuesve, prodhuesve të fonogramave dhe transmetuesve më shumë të drejta të veçanta. Këto të drejta quhen të drejta të lidhura sepse ato lidhen ngushtë me të drejtën e autorit.

Kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtave të lidhura varet nga ligji kombëtar i çdo vendi. Në përgjithësi, mbrojtja minimale zgjat: për interpretuesit, 50 vjet nga mbarimi i vitit në të cilin një shfaqje është fiksuar në fonogram; për prodhuesit e fonogramave, 50 vjet nga mbarimi i vitit në të cilin është botuar fonograma; për transmetuesit, 20 vjet nga mbarimi i vitit në të cilin është bërë transmetimi.

Interpretuesit

Shumë vepra arti nuk mund të vlerësohen plotësisht pa ndihmën e interpretuesve. Për shembull, një krijim muzikor zakonisht është më i pëlqyeshëm kur luhet nga një muzikant sesa kur lexohet në fletë muzikore. E njëjta gjë mund të thuhet për skenarët, dramat, dhe madje romanet, të cilat shumë njerëz i pëlqejnë kur interpretohen nga aktorë në skenë apo në ekran filmash.

Interpretuesit, të tillë si aktorët, muzikantët, kërcimtarët dhe këngëtarët, i japin jetë veprave të autorëve. Kur ata aktrojnë, luajnë një instrument, kërcejnë apo këndojnë, interpretuesit interpretojnë veprat me stilin e tyre unik. Interpretimet origjinale të veprave janë të çmueshme dhe për rrjedhojë të mbrojtura nga të drejtat e lidhura.

Në përgjithësi, intepretuesit mund të ndalojnë rregjistrimin dhe transmetimin e shfaqjeve të tyre direkte pa pëlqimin e tyre. Ata gjithashtu kanë të drejtë të ndalojnë, mes të tjerash, kopjimin e vazhdueshëm dhe transmetimin në internet të rregjistrimeve të tyre muzikore. Për shembull, një grup muzikor mund të ndalojë fansat nga rregjistrimi i shfaqjeve të tyre direkte. Ata gjithashtu mund t'u ndalojnë fansave të ngarkojnë në internet kopje të albumeve të grupit.

Pa këto të drejta, interpretuesit nuk do të paguheshin për interpretimet e tyre. Nëse dikush mund ta rregjistronte dhe ta transmetonte direkt një shfaqje artisti atëherë disa njerëz të cilët do të kishin blerë biletë për ta ndjekur shfaqjen mund të zgjedhin ta shohin transmetimin pa pagesë. Kopjet e rregjistruara pa pëlqimin e artistit nuk do të gjeneronin asnjë të ardhur për artistin. Nëse një artist nuk mund të fitojë të ardhura nga interpretimet e tij, ai do të duhet bërë një punë tjetër për të siguruar jetesën, dhe për rrjedhojë mund të rregjistrojë më pak vepra që t'i shijojmë ne.

Në disa vende, interpretuesit gjithashtu kanë të drejta të ngjashme me të drejtat morale të autorit. Këto të drejta mbrojnë interpretuesit nga shtrembërimet e interpretimeve të tyre. Ato gjithashtu u lejojnë atyre të kërkojnë që emrat e tyre të përmenden në lidhje me interpretimet e tyre.

Autore e re: Athena Adamopoulos

Për aq kohë sa ajo mban mend, Athena vazhdon të kompozojë muzikë në kokën e saj. Ajo luan në violimçel dhe në piano dhe i pëlqen të kompozojë vepra origjinale për të dyja instrumentat. Megjithatë, kur vjen puna për interpretimin e veprave të saj, ajo preferon të ulet dhe t'ua lërë muzikantëve të shquar të luajnë veprat e saj. Në fakt, ishte shfaqja e një prej kompozimeve të Athenës, Monologu, nga violomçelisti me famë botërore Yo Yo Ma në një transmetim në radio, me të cilin Athena fitoi njohje dhe respekt të madh si kompozitore e re. Athena ëndërron që një ditë të dëgjojë kompozimet e saj si pjesë e një çmimi muzikor për një film.

"Kur më lindi për herë të parë në mendje kjo vepër, e dëgjova pak a shumë si kjo, por jo tamam... dhe kjo është dhjetë herë më mirë se ajo"- Reagimi i Athenas pasi dëgjoi Yo Yo të interpretonte kompozimin e saj.



Në shenjë respekti: Athenas Adamopoulos

Prodhuesit e fonogramave



Një prodhues fonogramash është personi ose shoqëria e cila fikson (rregjistron tingujt) për herë të parë një shfaqje.

Një fonogram është rregjistrimi origjinal, ndërsa disqet dhe MP3 janë kopjet e këtij origjinali.

Rregjistrimi i tingujve të një shfaqje kërkon pajisje të shtrenjta teknike dhe punonjës të specializuar. Prodhuesit e fonogrameve rimarrin koston e kësaj pajisjeje dhe pune duke shitur kopjet e fonogramave në disqe ose MP3. Prodhuesit e fonogramave kanë të drejtë të autorizojnë ose ndalojnë njerëzit e tjerë t'i kopjojnë, transmetojnë dhe shpërndajnë fonogramet e tyre.

Duke qenë se është e vështirë dhe e shtrenjtë të prodhohet një rregjistrim i cilësisë së parë i një shfaqjeje, teknologjia e re e ka bërë shumë të lirë dhe të lehtë kopjimin e rregjistrimit origjinal. Nëse prodhuesit e fonogramave nuk do ta kishin të drejtën për të ndaluar të tjerët të riprodhonin fonogramat e tyre, shumë njerëz do t'i kopjonin ato pa pagesë në vend që të blenin disqet apo MP3 që përpiqen të shesin prodhuesit e fonogramave. Ky kopjim i pakontrolluar nuk do të sillte të ardhura për prodhuesit e fonogramave të cilët për rrjedhojë nuk do të ishin në gjendje të merrnin kostot e dhëna për rregjistrimin e shfaqjes origjinale. Nëse prodhuesit e fonogramave nuk do të bënin para me rregjistrimet e tyre origjinale, ata do të kishin më pak dëshirë të rregjistronin shfaqje në të ardhmen. Si rrjedhojë, më pak autorë dhe interpretues do të kishin shansin të rregjistronin veprat dhe shfaqjet e tyre. përveç kësaj konsumatorët do të kishin më pak zgjedhje për të dëgjuar rregjistrime të reja zanore.

Në shumë rregjistrime zanore, simboli  përdoret për të identifikuar pronarin e të drejtave të lidhura për rregjistrimin.

Organizatat e transmetimit



Transmetimet në radio dhe televizion i bëjnë veprat e autorëve dhe interpretimet e tyre nga artistët të disponueshme për një publik të gjerë. Për të inkurajuar organizatat e transmetimit të investojnë në teknologjinë e duhur për transmetimin e veprave, qeveritë garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të drejtave të lidhura për këto organizata.

Organizatat e transmetimit kanë të drejtë të autorizojnë ose të ndalojnë ri-transmetimin, rregjistrimin (fiksimin) dhe kopjimin e rregjistrimeve të transmetimeve të tyre.

Aktiviteti i krijimit

Me një grup shokësh, ose:

Krijoni, interpretoni dhe rregjistroni një video muzikore direkte:

- 1) Shkruani këngë lirike, kompozoni muzikën, koreografini një kërcim të caktuar;
- 2) Përzgjidhni muzikantin (ët), këngëtarin (ët) dhe kërcimtarin (ët) të intepretojë këngën;
- 3) Gjeni një vend për të interpretuar muzikën tuaj;
- 4) Skiconi një poster të promovojë shfaqjen;
- 5) Interpretoni këngën dhe rregjistroni shfaqjen tuaj.

ose

Krijoni, interpretoni dhe rregjistroni një skeç:

- 1) Shkruani skenarin e një skeçi që do të intepretohet, duke përfshirë drejtimet e skenës dhe dialogun;
- 2) Zgjidhni aktorët dhe caktoni një rregjizor t'ju ndihmojë ta vini skeçin në skenë.
- 3) Gjeni një vend për të interpretuar skeçin;
- 4) Skiconi një poster për të promovuar shfaqjen;
- 5) Interpretojeni dhe rregjistroni shfaqjen.

Pastaj analizoni:

- 1) Cilat janë të drejtat e autorit dhe/ose të drejtat e lidhura që çdo anëtar i ekipit tuaj ka në veprën dhe shfaqjen tuaj kolektive?
- 2) Sa kohë dhe para keni shpenzuar për të krijuar dhe për të intepretuar videon muzikore/skeçin?
- 3) Çfarë do të donit të bënit me veprën tuaj përfundimtare? (Për shembull: t'ja tregoni atë ekzekutuesve muzikorë për të lidhur një kontratë inçizimi; ta bëni disponibël për shkarkim pa pagesë në Internet; t'i shisni kopje të saj vetes tuaj; etj.)

Si menaxhohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura?

Para se ju apo dikush të mund të përdorë një vepër të mbrojtur nga e drejta e autorit dhe/ose të drejtat e lidhura, ju duhet të gjeni mbajtësit e të drejtave për t'i kërkuar lejen dhe nganjëherë të paguani për të drejtën e përdorimit të veprës. Ky proces quhet **dhënia e të drejtave**.

Autorët dhe interpretuesit (veçanërisht ata popullorë) mund të preken lehtë nga të gjithë kërkesat e njerëzve të cilët duan të riprodhojnë, transmetojnë, përshtatin ose ndryshe përdorin veprat dhe shfaqjet e tyre në një mënyrë që kërkon lejen e tyre. T'u japësh përgjigje gjithë këtyre kërkesave dhe të vendosësh nëse t'u japësh apo jo lejen pa pagesë apo kundrejt një tarife mund të kërkojë shumë kohë.

Këto kërkesa janë shumë të rëndësishme meqenëse duke dhënë lejen nëpërmjet licensave dhe transferimeve autorët dhe artistët marrin pagesat e honorareve të tyre. Me qëllim që të kenë kohë për të vazhduar krijimin dhe interpretimin ndërkohë që ende vazhdojnë të pranojnë të gjitha kërkesat, shumë autorë dhe artistë mbështeten në shërbimet e **Organizatave të Menaxhimit kolektiv**. Këto organizata veprojnë si një lidhje ndërmjet autorëve e artistëve dhe atyre që duan t'i përdorin veprat e tyre. Ata u japin të drejtën organizatave, të mbledhin pagesat e honorareve, dhe të hetojnë, parandalojnë dhe kërkojnë kompensim për përdorimet e paautorizuara. Falë këtyre organizatave, autorët dhe artistët marrin pagesat që meritojnë kur përdoren veprat dhe shfaqjet e tyre, dhe përdoruesit mund të marrin më lehtë leje për përdorimin e këtyre veprave dhe shfaqjeve.

Shumica e vendeve kanë organizata kombëtare të menaxhimit kolektiv, të cilat ju mund t'i kontaktoni për të menaxhuar të drejtat mbi veprat apo shfaqjet tuaja. Ju gjithashtu mund t'i kontaktoni këto organizata kur keni nevojë për lejen e përdorimit të veprave apo shfaqjeve të autorëve të tjerë.

Organizatat kombëtare të menaxhimit kolektiv zakonisht i përkasin një shoqate (grupi) ndërkombëtar të këtyre organizatave. Për të gjetur organizatën kombëtare që mund t'ju ndihmojë të menaxhoni të drejtat tuaja si autor, apo t'ju drejtojë sesi të merrni lejen e përdorimit të veprës apo shfaqjes së dikujt tjetër, ju mund të kontaktoni shoqatën ndërkombëtare.


Më poshtë jepen linket e internetit për disa nga shoqatat më të njohura ndërkombëtare që ndihmojnë autorët, artistët, prodhuesit e fonogramave, dhe organizatat e transmetimit të zbatohen të drejtat e tyre:

- ◆ Shoqata e Organizatave të Artistëve Europeanë
<http://www.aepo.org>
- ◆ Konfederata Ndërkombëtare e Shoqërive të Autorëve dhe Kompozitorëve
<http://www.cisac.org>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Aktorëve
<http://www.fia-actors.com>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Muzikantëve
<http://www.fim-musicians.com/eng/index.html>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Organizatave të Riprodhimit të të Drejtave
<http://www.ifrro.org>
- ◆ Federata Ndërkombëtare e Industrisë Fonografike
<http://wifpi.org/>

Lojë: Saktëso të drejtat*

Shikoni me vëmendje më poshtë kopertinat dhe hollësitë e këngës së diskut imagjinar. Identifikoni se leja e kujt ju nevojitet nëse:

- Këndoni një këngë me titull Indigo në shfaqjen tjetër publike të grupit tuaj.
- Hidhni këngë nga albumi në faqen tuaj të internetit.
- Riprodhoni punën artistike të kopertinës mbi një bluzë.
- Transmetoni këngë me titullin Indigo në kanalin e radios së qytetit tuaj.
- Rregjistroni melodinë e këngës me titull Indigo për ta përdorur si sfond muzikor për një film që po xhironi.
- Përdorni lirikën e korit të këngës me titull Indigo si pjesë e këngës që po kompozoni.



*Shih faqen 59 për përgjigjet

SEKTORI PUBLIK

DHE KUFIZIMET E TË DREJTËS SË AUTORIT

Ligjet e të drejtave të autorit përpiqen të gjejnë një ekuilibër ndërmjet të drejtave që u jepen autorëve dhe të drejtës së publikut për t'i pasur dhe për t'i përdorur këto vepra. Edhe autorët përfitojnë nga aftësia për të patur dhe përdorur veprat e autorëve të mëparshëm që i frymëzojnë dhe i ndihmojnë ata të mësojnë teknikat që ata mund të përdorin për të zhvilluar vepra të reja. Sektori publik dhe kufizimet e të drejtës së autorit e bëjnë këtë ekuilibër ndërmjet të drejtave të autorëve dhe të drejtave të publikut.

Çfarë është sektori publik?

Sektori publik konsiston në të gjitha veprat që nuk mbrohen nga e drejta e autorit dhe për rrjedhojë janë të lira të përdoren pa lejen e autorit ose pa pagesë kundrejt tij. Kjo do të thotë se veprat e sektorit publik mund të kopjohen, shpërndahen, përshtaten, interpretohen dhe shfaqen në publik sikur ato të zotëroheshin nga publiku.

Veprat bëjnë pjesë në sektorin publik kur:

- ◆ **Skadon mbrojtja e të drejtës së tyre të autorit.** Siç u përmend më sipër, afati i mbrojtjes së të drejtës së autorit ndryshon nga vendi në vend por ajo zakonisht skadon pas 50 deri 70 vite pas vdekjes së autorit.
- ◆ **Ato nuk kualifikohen për mbrojtjen e të drejtës së autorit.** Faktet dhe listat nuk kualifikohen për mbrojtjen e të drejtës së autorit, kështu që lista e ingredientëve në një recetë dhe datat në një kalendar janë të dyja në sektorin publik. Megjithatë, përshkrimi sesi të përdoren ingredientët e recetës dhe vepra e artit që përfshihet në një kalendar mund të konsiderohet si shprehje origjinale dhe për rrjedhojë të mbrohen nga e drejta e autorit. Përveç kësaj, në disa vende, dokumentat qeveritare nuk kualifikohen gjithashtu për mbrojtje të të drejtave të autorit. Për shembull, Administrata Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA)



është një agjenci qeveritare e Shteteve të Bashkuara e cila prodhon shumë imazhe dhe video që nuk kualifikohen për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe për rrjedhojë janë në sektorin publik. Ju mund të gjeni veprat e sektorit publik të NASA në: <http://www.nasa.gov/multimedia/imagegallery/index.html>

Dijeni se!!

Veprat që nuk botohen më ose nuk janë më disponibël për shitje nuk janë të domosdoshme në sektorin publik. Përveç rastit kur të drejtat e tyre të autorit kanë skaduar, duhet marrë përsëri leje nga mbajtësit e të drejtave para se veprat të kopjohen, printohen, shpërndahen apo përdoren në mënyrë tjetër.

Si mund të përdoren veprat në sektorin publik?

Veprat në sektorin publik mund të përdoren nga të gjithë në çdo mënyrë. Merrni për shembull, pikturën Britma nga artisti norvegjez Edvard Munch. Që kur kjo pikturë u fut në sektorin publik, ajo është riprodhuar në postera, libra artistikë, kukulla plastike, zinxhirë çelësash, multiplikativë, dhe në produkte të tjera të pafundme. Bizneset e veçanta që i shesin këto riprodhime nuk janë të detyruar të paguajnë honorare për përdorimin tregtar të kësaj vepre të sektorit publik.



Veprat në sektorin publik, të tilla si Britma e Munch mund të kopjohet, përshtatet dhe shpërndahet pa pagesë nga kushdo.

Në shenjë respekti: Associated Press

Dijeni!!

Veprat në sektorin publik shpesh përdoren nga autorë të ndryshëm për të krijuar vepra të reja. Kur një vepër origjinale përkthehet, përshtatet apo ndryshohet në një formë tjetër, vepra e re quhet **vepër e derivuar**. Veprat e derivuara mbrohen gjithashtu nga e drejta e autorit, edhe nëse veprat origjinale prej të cilave kanë rrjedhur të bëjnë pjesë në sektorin publik. Personi që krijoi veprën e derivuar është autori i saj dhe mban të drejtën e autorit. Cilido që dëshiron të përdorë (riprodhojë, përkthejë, përshtatë etj.) një vepër të derivuar që mbrohet nga e drejta e autorit duhet të marrë leje nga autori i veprës së derivuar.

Kur kërkoni për vepra të sektorit publik që t'i përdorni si pjesë të krijimeve tuaja të reja, sigurohuni që versioni që po përdorni të jetë origjinali, versioni i sektorit publik, dhe të mos jetë një vepër e derivuar e cila ende mund të mbrohet nga e drejta e autorit.

Për shembull, teksti origjinal nga Lewis Carroll dhe ilustrimet nga John Tenniel për librin Aventurat e Lizës në botën e çudirave, botuar për herë të parë në 1865, janë në sektorin publik dhe mund të përdoren pa pagesë nga kushdo. Megjithatë, filmi, skicat, personazhet multiplikativë, tregtimi, etj., të krijuara nga Uollt Diznej në 1951, të cilat janë një përshtatje e Lizës origjinale të Carrol, mbrohen ende nga e drejta e autorit dhe nuk mund të përdoren pa lejen e shoqërisë Uollt Diznej. Përveç kësaj, piktura e Lizës e treguar më poshtë është rregjistruar si markë tregtare dhe kjo e ndalon atë të hyjë në sektorin publik, edhe pasi e drejta e tij e autorit të skadojë.

Skicat origjinale të Lizës nga John Tenniel sot janë në sektorin publik, por skicat e përshtatura nga Uollt Diznej janë ende nën mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të markës tregtare.



Kompozimet origjinale të Shopenit janë në sektorin publik, por rregjistrimet e fundit të këtyre kompozimeve mund të mbrohen ende nga të drejtat e lidhura.

Kur kërkoni për një vepër në sektorin publik, mos harroni të drejtat e lidhura. Për shembull, ndërkohë që krijimet muzikore klasike, të tilla si ato të krijuara nga Shopeni, sot janë në sektorin publik, shfaqjet e fundit dhe rregjistrimet e këtyre krijimeve mund të mbrohen ende nga të drejtat e lidhura. Kjo do të thotë se ju mund të përdorni krijimin origjinal duke e luajtur atë në një recital publik apo pjesë përbërëse të saj në një këngë që po krijoni. Megjithatë, nuk mund të kopjoni, shpërndani, transmetoni, apo përdorni në asnjë mënyrë tjetër, rregjistrimet e këtij krijimi që ende mbrohen nga të drejtat e lidhura.

Interpretues i ri: Evgeny Kissin

Pianisti me famë botërore Evgeny filloi të luajë në piano kur ishte vetëm dy vjeç. Në moshën 12 vjeçare ai interpretoi Koncertet 1 dhe 2 për Piano të Shopeni-t me Orkestrën Filarmonike të shtetit të Moskës dhe u bë i famshëm. Që atëherë, Evgeny ka dhënë koncerte në mbarë botën, ka bërë dhjetëra rregjistrime dhe ka fituar shumë çmime.

Muzika që ai luan zakonisht është e kompozitorëve si Shopen, Moxart, Bethoven, Çajkovski dhe Shuman, veprat e të cilëve bëjnë pjesë në sektorin publik. Megjithatë interpretimet e këtyre veprave nga Evgeni mbrohen nga të drejtat e lidhura. Falë këtyre të drejtave, Evgeny mund të fitojë jetesën për vete dhe familjen e tij nga koncertet dhe rregjistrimet e tij.

Evgeny Kissin ka siguruar jetesën duke shfaqur veprat që janë në sektorin publik.



(Për respekt nga: Sheila Rock)
Nderim nga SCNY/BMG

Game: Public Domain Treasure Hunt*

Në Bashkimin Europian, e drejta e autorit për veprat letrare skadon 70 vjet pas vdekjes së autorit. Më poshtë është një listë e veprave të njohura letrare nga autorë evropianë. A mund të identifikoni katër vepra që ende nuk kanë hyrë në sektorin publik?



*shih faqen 60 për përgjigjet

Ku mund të gjenden veprat në sektorin publik?

Si rregull i përgjithshëm, shumë vepra të konsideruara klasike ose tradicionale janë aq të vjetra sa duhen për tu futur në sektorin publik. Megjithatë, të gjesh vepra të tjera të fundit që janë në sektorin publik nuk është gjithmonë e lehtë. Siç e pamë deri tani, duhen ndjekur këto hapa kur kërkojmë një vepër në sektorin publik?

- 1) Të dini specifikat e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në vendin tuaj: sa kohë zgjasin ato për çdo lloj vepre, dhe cilat vepra nuk kualifikohen për mbrojtje. Për veprat që nuk janë krijuar në vendin tuaj, gjeni nëse vendi juaj dhe vendet në të cilat janë krijuar veprat janë anëtarë të Konventës së Bernës. Gjithashtu kontrolloni nëse vendi juaj zbaton rregullin e afatit më të shkurtër, që do t'iu ndihmojë të vendosni nëse një vepër që tashmë është në sektorin publik në vendin ku është krijuar a është gjithashtu në sektorin publik në vendin tuaj.
- 2) Qartësohuni nëse vepra që doni të përdorni është vepër origjinale apo vepër e derivuar, e cila mund të ketë mbrojtje shtesë të të drejtave të autorit dhe/apo të të drejtave të lidhura.
- 3) Kontrolllo njoftimin e të drejtës së autorit dhe afatet e përdorimit të përfshira në vepër. Ky njoftim do t'iu ndihmojë të identifikoni mbajtësit e të drejtave dhe llojet e të drejtave të rezervuara. Ky hap është veçanërisht i rëndësishëm kur kërkon për vepra në internet.

Dijeni se!!!

Disponibiliteti i një vepre në internet nuk do të thotë që ajo hyn në sektorin publik dhe është e lirë për përdorim nga kushdo. Gjithmonë konsultohuni me paragrafet e kushteve të përdorimit në faqet e internetit para se të përdorni, shpërndani apo ndryshe përdorni diçka që e gjeni në internet.

- 4) Kontrolloni që vepra të mos jetë e mbrojtur nga ndonjë tip tjetër pronësie intelektuale, të tilla si markat tregtare (shpesh të identifikuara me simbolet ® ose TM).

Nese pas këtyre kontrolleve bazë ju ende nuk jeni të sigurtë nëse vepra është në sektorin publik, më e mira është të kërkonte leje para se ta përdorni. Modeli i letrës së lejes në faqen 65 do t'ju japë një ide sesi ta kërkonte një leje të tillë.

Cilat janë kufizimet e të drejtës së autorit?

Ligjet kombëtare lejojnë që veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura të përdoren lirisht në situata të veçanta. Në raste të tjera, ligjet kombëtare lejojnë veprat të përdoren pa i kërkuar mbajtësit të së drejtave leje për aq kohë sa ai është i shpërblyer për këtë përdorim. Falë këtyre kufizimeve të të drejtës së autorit, edhe veprat që nuk janë në sektorin publik nganjëherë mund të përdoren pa i kërkuar leje autorit, apo artistit ose pa i paguar atij honoraret. Megjithatë, mund t'i jepet ende kredi autorit, artistit, prodhuesit apo fonogrameve, dhe transmetuesit të veprës duke përmendur emrat e tyre dhe burimin e veprës.

Për shembull, përdorimet pa pagesë aplikohen kur veprat janë përdorur në:

- ◆ Citate
- ◆ Mësimdhënie
- ◆ Lajme raportuese

Përveç kësaj, disa ligje kombëtare lejojnë gjithashtu kopjimin e një vepre ekskluzivisht për përdorim personal, privat dhe jo-tregtar. Kjo do të thotë për shembull se ju mund të printoni një imazh të mbrojtur nga e drejta e autorit nga interneti për ta ngjitur atë në murin tuaj për kënaqësi private dhe personale, por ju nuk mund të përdorni të njëjtin imazh për të prodhuar bluza dhe për t'i shitur ato (përdorim tregtar).

Faqet e internetit të listuara më poshtë mund t'ju ndihmojnë të gjeni veprat që janë ose në sektorin publik ose disponibël për përdorim të lirë. Megjithatë, ju bëjmë të ditur se informacioni në këtë faqe është vetëm tregues dhe se nuk jep një pamje përfundimtare të statusit ligjor të veprave në vendin tuaj. Gjithashtu, para se të përdorni secilën prej veprave të listuara në këto faqe interneti, mos harroni të kontrolloni paragrafet e Kushteve të përdorimit.

Imazhet

- ◆ Big Foto
<http://www.bigfoto.com>
- ◆ morgueFile
<http://www.morguefile.com>
- ◆ Pics4learning
<http://www.pics4learning.com>

Literatura

- ◆ The online Books Page
<http://onlinebooks.library.upenn.edu>
- ◆ Project Gutenberg
<http://www.gutenberg.org>
- ◆ OpenflicxTM
<http://www.openflicx.com>

Muzikë

- ◆ Gutenberg Music
<http://gutenberg.org/music>
- ◆ Mutopia
<http://www.ibiblio.org/mutopia>
- ◆ Sheet Music Digital
<http://www.sheetmusicdigital.com>

SHKELJA E TË

DREJTËS SË AUTORIT

Çfarë është e drejta e autorit?

Shkelja ndodh kur përdoret një vepër e mbrojtur nga të drejtat e autorit (riprodhohet, përkthehet, përshtatet, shfaqet ose interpretohet në publik, shpërndahet, transmetohet, ose komunikohet në publik) pa lejen e mbajtësve të të drejtave ose përtej kufizimit të të drejtës së autorit.

Shkelja e të drejtës së autorit zvogëlon mundësitë që autorët kanë për të fituar të ardhura nga veprat e tyre, dhe na dëmton të gjithëve duke ulur iniciativën e autorëve për të krijuar vepra të reja që mund t'i shijojmë.



Ç'është plagjiarizmi?

Plagjiarizmi është akti i kopjimit të një vepre, tërësisht ose pjesërisht dhe më pas pretendimi për të qenë autor origjinal i saj.

Siç e pamë në pragrafin e mëparshëm, vetë idetë nuk mbrohen nga e drejta e autorit, kështu që nuk përbën gabim nëse shkruajmë një ide që e gjejmë në një vepër tjetër. Megjithatë, për të shmangur plagjiaturën, ne duhet ta shprehim idenë me mënyrë tonë unike.

Nganjëherë një autor e ka shprehur një ide kaq mirë sa që ne nuk mund ta themi dot më mirë me fjalët tona. Në këto raste, ne mund të kopjojmë fjalë për fjalë tekstin origjinal për aq kohë sa përdorim "shenjat e citimit". Këto shenja e informojnë lexuesin se ky tekst i veçantë është marrë nga vepra e një autori tjetër. Autori origjinal duhet të përmendet sipër tekstit ose poshtë citimit, ose me një shënim në fund të faqes.

Shumica e shkollave, universiteteve dhe bizneseve kanë rregulla të forta kundër plagjiarizmit. Ndërkohë që interneti mund ta thjeshtojë mjaft

kopjimin dhe marrjen e veprës së një personi tjetër dhe ta deklarojë atë si të veten, pasojat e plagjiarizmit mund të jenë shumë të rënda. Studentët që bëjnë plagjiaturë rrezikojnë të përjashtohen nga shkolla.

Duhet të dini!



Një kopje mund të konsiderohet shkelje edhe nëse ajo nuk është saktësisht e njejtë si vepra origjinale. Në fakt, shkelja ndodh kur kopja është në thelb e ngjashme. Kjo zakonisht përcaktohet nga gjykata, e cila krahason gjuhën, paraqitjen, formatin, sekuencën, zërin, etj. e veprës origjinale dhe veprës që akuzohet për shkelje.

Që të kemi shkelje duhet që shkelësi të jetë futur në veprën origjinale. Gjithsesi mund të ndodhë që i akuzuari të ketë krijuar një vepër të ngjashme krejt rastësisht, pa e parë ndonjëherë veprën origjinale. Nëse është kështu, nuk ka plagjiaturë.



Ç'është pirateria?

Termi Pirateri zakonisht i referohet shitjes së qëllimshme dhe jo të ligjshme të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit.

Muzika është lloji i veprës që piratohet më shpesh, megjithëse edhe veprat e tjera të tilla si filmat, video games dhe programet e kompjuterit janë gjithashtu viktime të piraterisë. Pirateria është një aktivitet i paligjshëm që dëmton jo vetëm autorët, artistët, prodhuesit e fonogrameve, dhe transmetuesit, por gjithashtu mbarë shoqërinë.

Kopjet e piratuara të veprave shpesh shiten:

- ◆ me çmim shumë të ulët;
- ◆ nga shitësit e rrugës në tregje, shitjet me makinë lëvizëse ose vende të tjera informale, si dhe në dyqane të fiksuara;
- ◆ në kompakt disqe të rregjistrueshme (CD-Rs);
- ◆ si kompilacione MP3 të albumeve nga artistë të ndryshëm;
- ◆ me inserte të cilësisë së dobët (imazhe dhe tekst të turbullt; letër të lirë dhe të prerë keq me printim vetëm nga njëra anë; me fjalë të shkruara me gabime dhe me shkrim dore; me mbështjellje plastike jo të mbyllur ose pa mbështjellje fare);
- ◆ pa shënimin ©.

Arsyet pse duhet të shmangim blerjen e kopjeve të veprave të piratuara përfshijnë:

- 1) **pirateria heq shpërblimin financiar që meritojnë autorët dhe ul aftësinë e tyre për të vazhduar të krijojnë vepra të reja.** Asnjë para nga shitja e një disku të piratuar nuk i shkon autorëve apo interpretuesve të këngëve në atë disk. Nëse autorët dhe interpretuesit nuk mund të fitojnë të ardhura nga shitja e veprave të tyre, atëherë ata mund të kenë nevojë të gjejnë punë të tjera për të siguruar jetesën. Këto punë të tjera mund të marrin shumë kohë dhe kështu ata s'janë më në gjendje të vazhdojnë të krijojnë dhe interpretojnë vepra të reja.

"Të bësh një album është një përpjekje në ekip, kështu që kur dikush piraton një rregjistrim kjo ndikon jo vetëm tek artisti por edhe tek njerëzit që punuan për të si tek bashkëprodhuesit, bashkë-autorët dhe muzikantët. Thuaji jo piraterisë." - Shakira në musicunited.org

- 2) **Pirateria zvogëlon iniciativën që shoqëritë botuese dhe distributore të investojnë për autorë dhe interpretues të rinj.** Kushton shumë para të zbulosh, zhvillosh, rregjistrosh dhe promovosh autorë dhe interpretues të rinj. Nëse, për shkak të piraterisë, botuesit dhe distributorët ligjorë nuk mund të rimarrin investimet e tyre nga fitimet e shitjeve të veprave që ata kanë ndihmuar të prodhohen, ata do të kenë më pak fonde investimi për autorë dhe interpretues të rinj. Kjo do të thotë që autorët dhe interpretuesit e rinj do të kenë më pak mundësi të fitojnë një kontratë botimi dhe distribucioni. Do të thotë gjithashtu që konsumatorët do të kenë më pak zgjedhje për një muzikë të re.
- 3) **Konsumatorët nuk janë të mbrojtur ndaj kopjeve të rreme.** Cilësia e produkteve të piratuara shpesh është më e ulët sesa ajo e origjinaleve. Kur konsumatorët kanë probleme me një produkt ligjor, ata mund të ankohen tek dyqani ku e kanë blerë dhe të marrin paratë mbrapsht ose një kopje të re. Nga ana tjetër, kur konsumatorët blejnë një kopje të piratuar, nuk ka garanci që atyre tu kthehen paratë ose të ndërrojnë produktin me të meta me një tjetër të rregullt. Në shumë raste, ata vështirë mund ta gjejnë të njëjtën shitës pirat përsëri!

- 4) **Pirateria i bën kopjet ligjore më të shtrenjta.** Me qëllim që të rikthejnë humbjet e tyre nga pirateria, botuesit dhe distributorët mund të rritin çmimet e kopjeve ligjore të veprave.

Çfarë është kalimi i dokumentave nga kolegu tek kolegu?

Kalimi i dokumentave (P2P) është një mënyrë me të cilën përdoruesit e kompjuterit të cilët janë futur në të njëjtin rrjet në internet mund të ndajnë së bashku dokumenta kompjuteri (si tekst, muzikë dhe/ose video).

Shkarkimi dhe ngarkimi që bëhet për të ndarë P2P file përfshin kopjimin dhe prodhimin e veprës në publik - të cilat të dyja janë të drejta ekskluzive të autorit (ose të mbajtësve të tjerë të të drejtave) të veprës. Për rrjedhojë, kur bëhet pa lejen e mbajtësve të të drejtave, ndarja e P2P file është shkelje e të drejtës së autorit. Disa platforma përdorimi të P2P file janë shërbime legjitime, të cilat marrin autorizimet e nevojshme nga mbajtësit e të drejtave. Për fat të keq, është vlerësuar se shumica e files që shpërndahen në rrjete P2P janë të paautorizuara dhe për rrjedhojë të paligjshme.

Kompjuterat, interneti, dhe teknologjitë e tjera dixhitale të tilla si formatet MP3 janë mjete të mrekullueshme që na ndihmojnë të punojmë më shpejt dhe të marrim një pafundësi informacioni rreth botës tonë. Methithatë, këto mjete krijojnë gjithashtu një sfidë të madhe për autorët duke i bërë më të prekshme veprat e tyre. Me teknologjinë dixhitale është e lehtë dhe e lirë të kopjosh në mënyrë të përsosur dhe të shpërndash veprat në mbarë botën për pak sekonda. Ndërkohë që një autori mund t'i duhen vite të krijojë fjalët e duhura dhe të gjejë melodinë e duhur për një këngë të suksesshme, për një përdorues kompjuteri zgjat vetëm pak sekonda ta kopjojë atë këngë në një file në kompjuterin e tij dhe ta shpërndajë atë (në rrjete p2p) tek miliona njerëz në glob.

Arsyet pse nuk duhet të ngarkojmë/shkarkojmë kopje të paligjshme të veprave kanë brenda:

- 1) **Rrezikun e viruseve të kompjuterit dhe piraterisë informatike.** Files e shkarkuara të muzikës mund të përmbajnë viruse. Përveç kësaj, programi P2P nganjëherë mund të përmbajë "spyware" i cili grumbullon informacion rreth kompjuterit pa dijeninë dhe pëlqimin e përdoruesit. Programi P2P që lejon shpërndarjen e files muzikore mund t'u lejojë gjithashtu të huajve t'u shfaqen dokumenta të tjera në kompjuter që përdoruesi nuk do të dontë t'ia shohin.
- 2) **Risku i padive.** Interneti nuk është anonim, është e mundur të identifikohen individët të cilët ngarkojnë dhe shkarkojnë në mënyrë të paligjshme materiale me të drejta autori në rrjetet P2P. Që nga viti 2003, industria muzikore ka demonstruar se ajo do të padisë përdoruesit e paligjshëm, pavarësisht moshës së tyre.
- 3) **Zgjedhja e reduktuar e muzikës.** Shpërndarja e paligjshme e file P2P zvogëlon blerjet e disqeve të ligjshme që do të thotë se studiot e regjistrimit e kanë më të vështirë të rimarrin investimin e tyre për artistët. Duke investuar tek një talent i ri, një biznes riskues, shpërndarja e paligjshme e file P2P ua bën më të vështirë autorëve dhe interpretuesve të rinj të firmosin kontrata produksioni dhe distribucioni. Studiot regjistruese gjithashtu mund të përpiqen të ulin riskun e mos kthimit të investimit të tyre duke prodhuar vetëm llojin mesatar të muzikës që pëlqen shumica e njerëzve, duke iu dhënë më pak mundësi autorëve dhe interpretuesve krijues dhe vertetë origjinale të lidhin kontrata.

"...sa më shumë të ndodhë shkarkimi i paligjshëm, aq më shumë do të vuajnë shoqëritë e regjistrimit, për më tepër që ata po përqëndrohen vetëm tek arstitët e mëdhenj dhe ata më të vegjlit, që ndoshta po bëjnë vërtetë muzikë më të mirë, nuk po dëgjohen." -

Dido në whatsthe download.com

- 4) **Shkarkimi i muzikës në mënyrë të ligjshme nuk ka qenë kurrë më i lehtë.** Ka qindra faqe interneti ku muzika mund të shkarkohet në mënyrë të ligjshme ose me pagesë të veçantë vetëm për këngën ose në bazë pajtimi. Faqja e mëposhtme jep linket e përditësuara të shumë faqeve shkarkuese të ligjshme:

<http://www.pro-music.org/musiconline.htm>

Lojë: Mbrojtja e autorëve dhe artistëve

Ju e kuptoni qëllimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe e të drejtave të lidhura dhe dëshironi që të respektohen të drejtat e autorëve dhe artistëve që ju admironi. A mund të identifikoni më poshtë cilat janë veprime të ligjshme dhe cilat të paligjshme?



- | | | | |
|----|--|------------|--------------|
| 1. | T'i bëni një kopje diskut të shokut të klasës për MP3 tuaj: | E ligjshme | E paligjshme |
| 2. | T'i jepni një shoqeje një disk të cilin e bletë për të si dhuratë: | E ligjshme | E paligjshme |
| 3. | T'i jepni një shoku të klasës një kopje disku të cilit e keni blerë për vete: | E ligjshme | E paligjshme |
| 4. | Të shkëmbeni një disk në një rrjet të paautorizuar P2P: | E ligjshme | E paligjshme |
| 5. | Të shisni një disk që ju e keni blerë nga shitja e një garazhi të dorës së dytë: | E ligjshme | E paligjshme |
| 6. | Të ngarkoni një këngë të shkruar, të kompozuar dhe të interpretuar nga ju në një faqe interneti shkarkimi pa pagesë: | E ligjshme | E paligjshme |
| 7. | T'i dërgoni një shoku klase me e-mail një MP3 file me këngën tuaj të preferuar: | E ligjshme | E paligjshme |

Çfarë është menaxhimi i të drejtave dixhitale?

Për të mbrojtur veprat e tyre nga shkeljet, mbajtësit e të drejtave po përdorin të njëjtat mjete që i bënë veprat e tyre aq të pambrojtura të jenë në vend të parë - teknologjitë dixhitale. Përdorimi nga ata i këtyre teknologjive, të cilat e bëjnë shkeljen e të drejtave të autorit më të vështirë dhe lehtësojnë menaxhimin e të drejtave, njihet si **Menaxhimi i të Drejtave Dixhitale** (MDD).

Mjetet MDD mund të përdoren për të shënuar veprat dixhitale me informacionin e të drejtës së autorit. Ato mund të përdoren gjithashtu për të kontrolluar mënyrën në të cilën mund të përdoret një vepër. Për shembull, MDD mund të kufizojë numrin e kopjeve që mund të bëhen nga një vepër, mund të parandalojnë ndryshimet që mund t'i bëhen një vepre, dhe mund të kufizojnë pajisjet me të cilat mund të shijohet një vepër.

Sipas ligjeve ndërkombëtare, është e paligjshme të hiqet, ndryshohet (moderohet) ose anashkalohet mbrojtja MDD e një vepre.

Si mund të mbrohen veprat në internet?

Si autor, ju mund të doni që veprat tuaja të shihen nga njerëzit e tjerë duke i hedhur ato në internet, ndërkohë që ende ato mbajnë të drejtat që ju janë dhënë ju nga e drejta e autorit. Gjëja e parë që duhet të bëni është të vendosni një shënim me emrin tuaj dhe vitin në faqen tuaj të internetit. Ju gjithashtu mund të dëshironi të përfshini një paragraf me Kushtet e përdorimit ku të specifikoni me saktësi se çfarë lejoni dhe çfarë nuk lejoni të bëjnë njerëzit me veprën tuaj. Për shembull, ju mund të lejoni vizitorët të printojnë një kopje të poezive apo skicave tuaja për përdorim të tyre personal, por i ndaloni ata t'i shesin këto vepra pa pëlqimin tuaj.

Kurdo që ju ngarkoni një material të ri, origjinal në faqen tuaj të internetit, printoni një kopje me data si dokument për ju. Kjo kopje mund t'iu duhet në të ardhmen për të provuar se jeni personi i parë që e keni hedhur këtë informacion në internet.

Ju gjithashtu mund të merrni në konsideratë përdorimin e disa teknologjive MDD për mbrojtje të veçantë. Për shembull, ju mund të përdorni shenjat e ujërave me emrin tuaj mbi të gjitha fotot tuaja në mënyrë që nëse njerëzit i printojnë apo i kopjojnë ato, emri juaj të shfaqet gjithmonë në fotot. Ju gjithashtu mund të vendosni të ngarkoni vetëm rregjistrime me cilësi të dobët ose versione të papërfunduara të veprave tuaja për ta bërë kopjimin më pak interesant.

Shenjat e ujërave janë një lloj i MDD që mund të ndihmojë të mbrohen imazhet e të drejtës suaj të autorit kundër përdorimit të paautorizuar.



Nëse pavarësisht njoftimeve tuaja për të drejtën e autorit dhe masave mbrojtëse ju konstatojnë se veprat tuaja përdoren pa lejen tuaj, ju duhet të kontaktoni shkelësin. Para së gjithash, megjithatë, printoni një kopje të materialit tuaj në faqen ku është bërë shkelja (me datën e dukshme) në mënyrë që shkelësi të mos mund dot ta fshijë materialin dhe të pretendojë se nuk ka ndodhur asgjë.

Gjeni hollësitë e kontaktit të shkelësit dhe dërgojini një e-mail ku deklaroni se ju jeni autori dhe pronari i të drejtës së autorit të veprës së veçantë të përfshirë në faqen ku është bërë shkelja. Pas kësaj ju mund t'i kërkonti shkelësit të: 1) largojë menjëherë nga faqja e internetit materialin tuaj me të drejta autori, 2) t'ju njohë ju si autorin e materialit, dhe/ose 3) t'ju paguaje honorarin për futjen e kësaj vepre në faqen e internetit. Jepini shkelësit një afat për t'iu përgjigjur mesazhit tuaj dhe për të bërë atë që i kërkuat me veprën tuaj.

Për fat të keq, shumë njerëz janë pa informacion mbi ligjet e të drejtave të autorit kështu që ekziston mundësia që shkelësi as që e di se postimi i veprës tuaj pa lejen tuaj është e paligjshme. Ka mundësi që shkelësi ta rregullojë problemin menjëherë dhe t'ju dërgojë një ndjesë. Nëse kjo nuk ndodh, ju mund të doni të merrni një avokat për t'iu dërguar një letër shtrënguese ligjore "Ndalim dhe pushim" dhe sipas rastit ta padisni shkelësin. Avokati mund t'ju ndihmojë gjithashtu për të informuar për shkeljen Furnitorin e Shërbimit Internet që mban Faqen e Internetit.




Lojë: gjej shkeljen*

A mund të dalloni ndonjë pjesë në faqen e mëposhtme të trilluar të internetit ku e drejta e autorit ka shumë mundësi të jetë shkelur?



KONKLUZIONET PËRFUNDIMTARE



Bota ku ne jetojmë rrethohet nga arti. Nga këngët që këndojmë në dush, tek ditari që shkruajmë, librat që lexojmë, filmat që shohim, dhe video lojrat që luajmë - dita jonë është e mbushur me shprehje artistike të krijuara nga ne dhe të tjerë.



Gjeni shprehjen artistike që ju përshtatet më mirë dhe përdorni imagjinatën tuaj për të krijuar vepra të reja, origjinale. Kërkojeni frymëzimin në veprat e autorëve të tjerë, dhe respektoni të drejtat e tyre me qëllim që t'i inkurajoni ata të vazhdojnë të krijojnë vepra që do t'ju ndihmojnë ju të zhvilloheni.



*Shih përgjigjet në faqen 61

PËRGJIGJET


E LOJRAVE

Lojë: Autori i ri formues



Bethoveni botoi veprat e tij të para muzikore në moshën 12 vjeçare.

Këto vepra u quajtën Variantet Dressler.



Frida Kahlo pikturoi autoportretin e saj të parë, Gruaja me fustan të kuq kur ishte 19 vjeçe.



Mary Shelley filloi të shkruante Frankeshtajn kur ishte 18 vjeç.



Moxarti shkruajti krijimin e tij të parë muzikor, Andante në C kur ishte 5 vjeç.



Pikaso krijoi pikturën e tij të parë të njohur, Le Picador, në moshën 8 vjeçare.



Uollt Diznej shiti vizatimet e tij të para në moshën 7 vjeç.


Lojë: Inspektori i të drejtës së autorit.

Armando Chico zotëron të drejtat morale të tekstit origjinal në gjuhën portugeze.

J. Little zotëron të drejtat morale mbi përkthimin e tekstit në gjuhën angleze.

Carlos Mayorga zotëron të drejtat e autorit të punës artistike mbi kopertinë.

Botuesit XYZ zotëron të drejtat e botimit.



Të drejtat ekonomike të përfshira në referimin "të gjitha të drejtat e rezervuara" mbulojnë të gjitha përdorimet ekonomike përkatëse të veprës, nëse ato janë licensuar apo transferuar apo i mbeten autorit. Këtu futen e drejta e: riprodhimit, përkthimit, përshtatjes, ekzpozimit apo e interpretimit të veprës në publik; e drejta e shpërndarjes, e transmetimit dhe e komunikimit të veprës në publik.

Lojë: Qartëso të drejtat



INDIGO leja e **The Blueberries** do të duhej për të kënduar këngën me titull Indigo në shfaqjen tjetër të grupit tuaj në publik.

Leja e **123 Record** do të duhej për të ngarkuar albumin në faqen tuaj të internetit. Gjithashtu do të kërkohej autorizimi i autorëve dhe i artistëve (The Blueberries) përveç rastit kur të drejtat e përfshira në përdorimin dixhital (riprodhim, duke e bërë të disponueshëm) i janë transferuar prodhuesit.

Leja e **Carlos Mayorga** do të duhej për të riprodhuar punën artistike të kopertinës së parme mbi një bluzë.

Parimisht, do të duhej leja e **The Blueberries** (autorëve) për të transmetuar këngën me titull Indigo në kanalin e radios së qytetit tuaj. Në shumë vende, artistët dhe shoqëria e regjistrimit (123 Records) do të kishin gjithashtu të drejtën e një shpërblimi.

Leja e **The Blueberries** do të duhej për të regjistruar melodinë e këngës me titull Indigo për ta përdorur si sfond muzikor për një film që po xhironi.

Leja e **The Blueberries** do të duhej për të përdorur lirikën e korit të këngës me titull The Indigo si pjesë e këngës që po kompozoni.

Lojë: Inspektori i Sektorit Publik

Kanë kaluar më pak se 70 vjet nga vdekja e autorëve të veprave të mëposhtëme, të cilat për rrjedhojë ende nuk kanë hyrë në sektorin publik:

© Herge - Moulinsart 2004

Aventurat e Tintin

Mbreti, Shtriga dhe Garderoba

Çarli dhe Fabrika e çokollatave

© Astrid Lindgren & Ingrid Vang Nyman/Saltrakan AB

Pipi Çorapegjata

Lojë: Mbrojtja e autorëve dhe e artistëve

- 1)  Të kopjosh diskun e shokut të klasës për MP3 tëndë është e paligjshme.
- 2) T'i japësh një shoqeje një disk që e ke blerë për të si dhuratë është e ligjshme sipas doktrinës së shitjes së parë.
- 3) T'i japësh një shoku klase një kopje disku që e ke blerë për veten tëndë është e paligjshme.
- 4) Të shkëmbesh një disk nga një rrjet i paautorizuar P2P është e paligjshme.
- 5) Të shesësh një disk që e ke blerë nga një shitës i dorës së dytë është e ligjshme sipas doktrinës së shitjes së parë.
- 6) Ngarkimi i një këngë të shkruar, kompozuar dhe të interpretuar nga ju në një faqe shkarkimi interneti pa pagesë është e ligjshme, sepse si autor, ju mund të bëni çfarë të doni me veprat që krijoni.
- 7) Dërgimi me e-mail tek një shoku i juaj i një MP3 file me këngën tuaj të preferuar është e paligjshme.

Lojë: Dalloni shkeljen

Përveç rastit nëse Ana ka marrë lejen nga mbajtësit e të drejtave dhe/ose është garantuar se veprat bëjnë pjesë në sektorin publik, ka shumë mundësi që ajo të ketë shkelur të drejtën e autorit duke ngarkuar files e mëposhtëme në faqen e saj të internetit:

- (3) ringtonet më të fundit të shkarkueshme/ (3) rregjistrimet e grupeve të mia të preferuara/
- (4) poezitë origjinale nga autorë të tjerë/ (7) fotot që skanova të aktorëve të mi të preferuar.

Duke qenë se është autorja e veprave të mëposhtëme, ajo mund të bëjë çfarë të dojë me to, duke përfshirë ngarkimin në faqen e saj të internetit: (1) krijimet e mia më të fundit/ (4) poezitë e mia/ (6) fotot që bëra verën e kaluar në Paris / (8) videon e mia shtëpiake për të qeshur.

Megjithëse lidhja me një faqe tjetër (ndiqni linket me faqe të tjera zyrtare të filmave të mi të preferuar (9) nuk është shkelje e autorit, konsiderohet e sjellshme të pyetet pronari i asaj faqeje nëse Ana mund t'i shtojë atyre një link në faqen e saj të internetit. Nëse ajo dëshiron të përdorë logon e faqes ku ajo është lidhur, ajo medoemos duhet të kërkojë leje.

Letrat e lejes

Para përdorimit (kopjimit, përshtatjes, interpretimit, shpërndarjes, etj.) të një veprë të mbrojtur nga e drejta e autorit, ju duhet të kërkonit leje nga autori apo nga mbajtësit e tjerë të të drejtave. Kjo leje zakonisht mund të kërkohet me letër ose me e-mail.

Nganjëherë, pjesa më e vështirë në kërkimin e lejes është të identifikohen dhe të gjenden hollësitë e kontaktit të mbajtësve aktualë të të drejtave. Nëse autori i veprës që doni të përdorni ka vdekur ose i ka transferuar të drejtat e tij, ju mund t'ju duhet të kërkonit për të gjetur mbajtësit aktualë të të drejtave.

- Për materialet e printuara (librat, revistat, fotot, etj.) vendi më i mirë për të filluar është të kontaktoni botuesit (detajet e kontaktit të tyre zakonisht jepen në fillim të veprës së printuar). Edhe nëse botuesit nuk e kanë të drejtën e autorit, ata zakonisht mund t'ju tregojnë se cilin duhet të kontaktoni.
- Për produktet multimedia të tilla si filma dhe programe televizive, njoftimi i të drejtës së autorit në fund do t'iu bëjë të ditur se kujt duhet t'i dërgoni kërkesën tuaj për leje. Ky informacion për të drejtën e autorit mund të gjendet gjithashtu në ambalazhin e DVD dhe videove.
- Faqet e internetit zakonisht kanë informacion rreth politikave të tyre mbi të drejtat e autorit tek paragrafi i Kushteve të Përdorimit. Paragrafi i kontaktit zakonisht jep adresën e e-mail ku ju mund të dërgoni kërkesën për leje.
- Për muzikën, kujtoni se duhet të merrni parasysh të drejtat e lidhura si dhe të drejtat e autorit. Nëse ju doni vetëm t'i përdorni fletët muzikore, atëherë ju duhet të kontaktoni me autorin (ose me botuesin e muzikës). Megjithatë, nëse ju doni të përdorni një rregjistrim, ju duhet të kontaktoni me autorin (botuesin) e muzikës si dhe me prodhuesin e regjistrimit. Informacioni se si të kontaktoni mund të gjendet në fletën muzikore ose në ambalazhimin e CD. Një mënyrë tjetër është të kontaktoni një organizatë kolektive menaxhimi e cila mund t'ju ndihmojë të identifikoni dhe lokalizoni mbajtësit e të drejtave.
- Në disa vende, një sistem rregjistrimi publik mund të japë informacionin që duhet për të kontaktuar me autorin e një vepre. Për të gjetur nëse vendi juaj e ka një sistem të tillë regjistrimi, kontaktoni zyrën tuaj kombëtare të të drejtës së autorit.

Sapo të dini cilin të kontaktoni, ju mund të filloni të përgatitni letrën tuaj. Letrat e lejes duhet:

- Të përmbajnë datën dhe emrin dhe hollësitë e kontaktit të mbajtësit të të drejtave.
- Të përshkruani shkurtimisht se kush jeni dhe projekti mbi të cilin po punonoi (arsyeja pse doni ta përdorni veprën).
- Përfshini informacion të detajuar rreth veprës (ose pjesës specifike

të veprës) që ju dëshironi të përdorni. Përdorni numrat ISBN për të identifikuar botimet e sakta të librave dhe linket URL për veprat e gjetura në internet.

- Shpjegoni me hollësi sesi do të përdoret vepra. Për shembull: sa kopje të veprës dëshironi të bëni; ku dhe për cilën audiencë dëshironi të interpretoni veprën; si doni ta përshtatni veprën (përkthejeni atë, jepni një pjesë të veprës së re etj.); ose si planifikoni ta shpërndani veprën (duke e hedhur atë në faqen tuaj të internetit, duke shitur kopje të printuara, etj.).
- Kërkoni konfirmimin që personi të cilit i drejtoheni është vërtet i vetmi mbajtës i të drejtave, dhe kërkoni informacion mbi mbajtësit e tjerë të të drejtave që duhet të kontaktoni.
- Kërkoni autorizim për të përdorur veprën e përshkruar.
- Kërkoni mënyrën me të cilën mbajtësi i të drejtave do të donte t'ju kreditonte veprën.
- Informoni mbajtësin e të drejtave për afatin e fundit për marrjen e lejes nga ai. Përpikuni t'i dërgoni kërkesën tuaj me kohë të mjaftueshme për të respektuar afatin por fiksoni mirë që mbajtësi i të drejtave nuk është i detyruar t'i përgjigjet letrës suaj. Një mospërgjigje nuk duhet konsideruar si leje për ta përdorur veprën.
- Përfshini hollësitë e kontaktit tuaj.

Modeli i dokumentit për letrën e kërkesës për leje:

[emri i mbajtësit të të drejtave]
[adresa e mbajtësit të të drejtave]
[data]

I dashur [emri i mbajtësit të të drejtave]:

Unë jam [përshkrim i shkurtër i vetes suaj të tillë si "një muzikant i ri" ose "një student arti"] aktualisht në punë për [përshkrim i shkurtër i projektit tuaj të tillë si "praktikimi i këngëve për një dramë në shkollë" ose "zgjedhja e shembujve të veprave për një projekt faqeje arti në internet"].

E kuptoj që ju zotëroni të drejtën e autorit për [titullin e veprës që doni të

përdorni, duke përfshirë numrin ISB ose linkun URL nëse jepet] dhe do të doja të kërkoja lejen tuaj të [përshkrimi se si dëshironi ta përdorni veprën - për shembull: ta interpretoni, ta kopjoni, ose ta ngarkoni në faqen tuaj të internetit, etj.] këtë vepër. [përfshini më shumë informacion se si do të përdoret vepra. Për shembull, kur planifikoni ta interpretoni veprën dhe kush do ta ndjekë shfaqjen: sa kopje të veprës dëshironi të bëni dhe kujt do t'i shpërndahen këto kopje; kush ka të drejtë të hyjë në faqen e internetit në të cilën ju doni të ngarkoni veprën; nëse ju planifikoni të tarifoni një pagesë për shfaqjen, kopjet, përdorimin e faqes së internetit, etj.]. Afati im i fundit për përfundimin e këtij projekti është [data në të cilën ju ju duhet një përgjigje nga mbajtësi i të drejtave].

Ju lutem përgjigjuni në adresën e mëposhtëme nëse jeni dakord të lëshoni lejen për përdorimin e lartpërmendur të veprës suaj. Nëse nuk jeni mbajtësi i vetëm i të drejtave mbi këtë vepër, ju lutem më informoni me kë duhet të kontaktoj tjetër për këtë kërkesë lejeje. Gjithashtu më bëni të ditur nëse keni ndonjë preferencë sesi duhet ta përdor veprën tuaj.

Ju falenderoj paraprakisht për marrjen në konsideratë të kësaj kërkesë nga ana juaj.

Singerisht,

[emri juaj]

[hollësitë e kontaktit tuaj duke përfshirë adresat postare dhe e-mail]

FJALORTH

Transferimi - Një mënyrë transferimi e një apo më shumë të drejtave ekonomike të autorit në mënyrë që personi që blen të drejtat të bëhet pronari i ri i të drejtës së autorit.

Autori - Si rregull i përgjithshëm, autori është krijuesi i një vepre.

Konventa e Bernës - Një marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtat e autorit, e cila parashikon një tërësi minimale të drejtash për autorët në të

gjitha vendet që janë anëtarë të Konventës.

Organizata e Menaxhimit Kolektiv - Një organizatë që ndihmon autorët, artistët, prodhuesit e fonogramave, dhe/ose transmetuesit të menaxhojnë të drejtat e tyre. ai mbledh pagesat nga përdoruesit dhe i shpërndan ato tek mbajtësit e të drejtave.

Vepra kolektive - një vepër e krijuar nga më shumë sesa një autor.

E drejta e autorit - një tërësi të drejtash të dhëna autorëve të veprave origjinale. nganjëherë termi "e drejta e autorit" përdoret në një kuptim të gjerë për të mbuluar gjithashtu të drejtat e lidhura.

Shkelja e të drejtës së autorit - Përdorimi i veprës me të drejta autori pa autorizimin e mbajtësve të të drejtave ose përtej kufizimit të të drejtës së autorit.

Vepra e derivuar - Një përshtatje apo përkthim i një vepre origjinale. Veprat e derivuara mbrohen gjithashtu nga e drejta e autorit.

Menaxhimi i të Drejtave Dixhitale (MDD) - Teknologjia dixhitale e përdorur nga mbajtësit e të drejtave për ta vështirësuar përdorimin e paligjshëm të materialeve të mbrojtura dhe për të lehtësuar menaxhimin e të drejtave të tyre.

Të drejtat ekonomike - të drejtat ekskluzive dhe ato të shpërblimit, të cilat i japin të drejtën mbajtësit të përfitojë financiarisht nga një vepër. Këtu hyjnë e drejta për të riprodhuar, përkthyer, përshtatur, shfaqur apo interpretuar veprën, shpërndarë, dhe komunikuar veprën në publik.

Doktrina e shitjes së parë - Një rregull që deklaron se e drejta e autorit për shpërndarjen e çdo kopje të veprës mbaron pas shitjes së parë të një kopje specifike.

Pronësia Industriale - Një lloj pronësie intelektuale, e cila përfshin patentat, markat tregtare dhe skicat industriale.

Pronësia intelektuale - Një degë e ligjit që mbrohet krijimet e mendjes njerëzore. Ajo ndahet në Pronësi Industriale edhe në të Drejtën e autorit.

Licensa - Një leje zyrtare për të kryer një veprim që zakonisht është i rezervuar për autorin e një vepre.

Të drejtat morale - Të drejtat e atësisë dhe integritetit, të cilat ruajnë një lidhje personale ndërmjet autorit dhe veprës së tij.

Ndarja e file shok me shok - Një mënyrë me të cilën përdorues të ndryshëm kompjuteri në internet të cilët janë futur në të njëjtin rrjet mund të ndanë files e kompjuterit (tekstet, muzikën dhe/ose video).

Pirateria - zakonisht i referohet shitjes së qëllimtë dhe të paligjshme të veprave me të drejta autori.

Plagjiarizmi - Akti i paraqitjes së veprës së një personi tjetër si i veti.

Spektori publik - Koleksioni i të gjitha veprave që nuk mbrohen nga e drejta e autorit dhe që për rrjedhojë janë të lira për tu përdorur pa marrë leje nga autori, ose pa paguar autorin.

Të drejtat e lidhura - Të drejtat e artistëve, prodhuesve të fonogramave, dhe organizatat e transmetimit.

Marrja e të drejtave - Procesi i kërkimit të lejes nga mbajtësit e të drejtave dhe duke i paguar atyre tarifën për përdorimin e një vepre të mbrojtur.

Mbajtësi i të drejtave - Pronari i të drejtës së autorit ose i të drejtave të lidhura të një vepre.

Honoraret - Një pagesë që i bëhet një autori nga personi që do të përdorë materialin e tij me të drejta autori.

Vepra - Një shprehje origjinale artistike.

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) - Një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara kushtuar zhvillimit të një sistemi të ekuilibruar dhe të aksesueshëm ndërkombëtar të pronësisë intelektuale.

Lexime të tjera

Broshurat e mëposhtme pa pagesë të botuara nga WIPO që japin informacione të tjera rreth patentave dhe formave të tjera të pronësisë intelektuale. Ju mund t'i shkarkoni ato në www.WIPO.int/publications. Ju mund të kërkoni gjithashtu një kopje në letër duke i dërguar një e-mail tek publications.mail@WIPO.int.

E drejta e autorit

Botimi Nr. 484

Patentat

Botimi Nr. 485

Markat tregtare

Botimi Nr. 483

Mëso nga e kaluara, krijo të ardhmen:

Shpikjet dhe patentat

Botimi Nr. 925

Botaj juaj e IP

Botimi Nr. 907

Në shtëpi me shpikjen

Botimi Nr. 865

Çfarë është Pronësia Intelektuale?

Botimi Nr. 450

Nga Artisti tek Audienca

Botimi Nr. 922

Duke shpikur të ardhmen

Botimi Nr. 917

Të dukesh mirë

Botimi Nr. 498

Prodhimi i një marke

Botimi Nr. 900

Te shprehurit krijues
Botimi Nr. 918

Bibliografi e përzgjedhur

Dikins, Rosie dhe Mari Griffith
The Usborne Introduction to Art
Londër: Usborne Publishing Ltd., 2003

Fishman, Stephen
Sektori Publik: Hoë to Find Copyright-Free Eërtings, Music, Art & More
Berkeley, CA: Nolo, 2000

Pimont, Marie-Renee
L'Imagerie des Arts
Paris: Editions FLEURUS, 2002

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO)
Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike
Gjenevë: WIPO, 1979

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO)
Manuali i Pronësisë Intelektuale
Gjenevë: WIPO, 2004

Burimet online

E drejta e autorit për fëmijët
<http://www.copyrightkids.org>

G.U.R.I
<http://www2.inpi.gov.br/Guri/index.jsp>

IP Kids
<http://www.ip-kids.gov.hk>

Iperckidz
<http://app.ipos.gov.sg/iperckidz/index.asp>

ProMusic
<http://www.pro-music.org>

Plaza de los ninos
http://www.derautor.gov.co/htm/Cartilla/plaza_de_los_ni%F1os.htm

Çfarë është shkarkimi
<http://www.ëhatstheoënload.com>

Shënim për mësuesit

Ky botim mund të përdoret për të plotësuar programin e letërsisë dhe të arteve, veçanërisht kur studentëve iu kërkohet të krijojnë vepra origjinale në këto fusha. Paragrafet "Mendo rreth saj" mund të jetë një pikë fillimi për diskutimet në klasë për rëndësinë e arteve dhe të të drejtës së autorit.

Mësuesit gjithashtu mund ta përgëzojnë këtë botim me një sesion në klasë që mbulon më shumë informacion specifik mbi ligjin e zbatueshëm kombëtar të drejtës së autorit. Ky informacion mund të gjendet në bazën e të dhënave WIPO's CLEA: <http://www.WIPO.int/clea/en/index.jsp>

Studentët inkurajohen të përfundojnë Aktivitetin krijues për të kuptuar përpjekjen dhe ata njerëz që janë përfshirë në krijimin, prodhimin, interpretimin dhe shpërndarjen e një vepre origjinale.

Së fundi, mësuesit mund ta përdorin këtë botim për të inkurajuar studentët e tyre të krijojnë më shumë vepra origjinale, të njohin të drejtat e tyre mbi këto vepra, dhe të respektojnë të drejtat e krijuesve të tyre.

Ky botim mund të fotokopjohet për përdorim në klasë siç është, pa asnjë

ndryshim.

Për çdo koment, pyetje dhe kërkesë ju lutem kontaktoni kids@WIPO.int.

